

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 11 / verë 2017

Editorial <i>Gëzim Spahija</i>	2
Riprodhimi i Strategjisë së Jezusit për Ndërtimin e Skuadrës në Kishën Tuaj <i>Neil B. Wiseman</i>	3
Si të Shkëputemi: Nga Kujdestarë në Pajisës <i>Greg Ogden</i>	11
Duke Çliruar Kishën: Një Përqasje e Organizuar <i>Craig E. Sweeney</i>	19
Procesi i Pajisjes në Kishën më të Vogël <i>Don R. Simmons</i>	26
Dishepullizimi në Nivelin Master <i>Marcia Lednicky</i>	28
Artikulli i KPAPSH: Ujë i Gjallë nga Pusi <i>Gëzim Spahija</i>	32



Tema: Pajisja e besimtarëve për jetë, shërbesë dhe udhëheqje



Pajisja e Besimtarëve për Jetë, Shërbesë dhe Udhëheqje

Perëndia na ka vendosur neve në krye si shërbetarë me qëllim që të kujdesemi çdo ditë për pajisjen e besimtarëve, për një jetë të shëndetshme dhe një shërbesë e udhëheqje të përkushtuar. Ekzistojnë dy elementë shumë të rëndësishëm të cilët janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe që janë boshti i vetëm që garanton sigurinë e suksesit.

Njëri prej elementëve është që të kemi Jezusin në qendër. Jezusi tha: *“Unë jam udha, e vërteta dhe jeta”* (Gjoni 14:6). Kush ka Krishtin në jetën e tij, ka jetë dhe jetë me bollëk të dhënë nga Perëndia.

Elementi tjetër është të kuptuarit e domethënies së jetës. Vëllai ynë i bekuar, Ravi Zakarias, ka thënë: *“Në qoftë se nuk ka një kuptim të madh në jetë ... atëherë jeta është pa një forcë shtytëse, pa substancën apo shpjegimin dhe pa motivimin e plotë”*. Kjo vjen nëpërmjet ndarjes dhe të jetuarit çdo ditë në shenjtërinë e Zotit të vërtetë, shenjtëri e cila na bën më të përlur për shërbesë ndaj Tij, më zemërgjerë dhe altruistë, me një vëmendje më të madhe për të tjerët, si dhe më të dashur e të gatshëm për të falur.

Kuptimi i jetës nuk do të na largojë nga detyrat e zakonshme të jetës së përditshme, por do të na aftësojë që të jetojmë si të krishterë kudo që Perëndia na ka thirrur në këtë jetë. Do ta aftësojë besimtarin që të kryejë detyrën e tij në shtëpinë e vet dhe në punë, dhe gjithashtu ky kuptim do të ndikojë në mënyrën sesi ai jeton në jetën e përditshme dhe si përballet me problemet e saj.

Kjo gjë na aftëson që të jetojmë një jetë:

- të përkushtuar dhe të fuqizuar në shërbesë duke e zbratur çdo ditë veten në lutje dhe duke e mbushur me gëzim të madh përmes Fjalës së Perëndisë.
- e cila konkretizohet vetëm nga ata që udhëheqin sipas modelit të Krishtit dhe synojnë vazhdimisht që të rriten në hir, në besim, në njohuri dhe në përshtatje ndaj vullnetit të Krishtit në çdo gjë.
- e cila vihet në zbatim nga ata persona që *“rendin drejt synimit”* (Filipianëve 3:14).

Ky është sekreti ynë i madh: të jetojmë gjithmonë me besim vetëm tek Krishti, dhe ta bëjmë këtë gjë duke u mbështetur tek Ai për forcën që na nevojitet. Ashtu sikurse mund të thoshte apostulli Pal: *“Për mua të jetuarit është Krishti dhe të vdekurit fitim”* (Filipianëve 1:21), si dhe: *“Nuk rroj më unë, po Krishti rron në mua”* (Galatasve 2:20), gjithashtu edhe ne duam ta dorëzojmë jetën tonë për shërbesë dhe udhëheqje nga Krishti.



GËZIM SPAHIJA, Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 11
Verë 2017

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Cel: (+355) 69-406-8956
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

RIPRODHIMI I STRATEGJISË SË JEZUSIT PËR **NDËRTIMIN e SKUADRËS**

NË KISHËN TUAJ

Nga: NEIL B. WISEMAN



Mënyra se si udhëhoqi Jezusi e mahniti të gjithë botën. Askush më parë nuk tërhoqi udhëheqës të ardhshëm nga radhët e besimtarëve të thjeshtë si Ai, përmes ideve revolucionare dhe kërkuese siç ishin nënshtrimi, sakrifica dhe shërbimi. Askush përveç Tij! Ai i çuditi të gjithë edhe më shumë kur përdori hir dhe dashuri për t'i gdhendur dishepujt e për t'i bërë të krishterë të guximshëm, të cilët u kthyen në anëtarët kryesorë të skuadrës fillestare të Kishës së hershme.

Tij, Ai i dha formë dhuntive, kualifikimeve dhe përvojave të secilit dishepull duke i kthyer ato në një forcë për ungjillin. Ai u tregoi atyre se kush ishin dhe iu dha një vizion për të parë se kush mund të bëheshin. Jo vetëm që Jezusi u tregoi atyre se si "bëhej" shërbesa, por Jezusi gjithashtu mori kohë për të shpjeguar "përse-në" e shërbesës. Madje, ai u dha atyre premtimin befasese se do të bënin gjëra edhe më të mëdha nga ato që kishte bërë Ai.

Jo vetëm që Jezusi u tregoi atyre se si "bëhej" shërbesa, por Jezusi gjithashtu mori kohë për të shpjeguar "përse-në" e shërbesës

Strategjitë e tij të udhëheqjes i habitën romakët, të cilët e sunduan botën me forcën e tyre ushtarake. Mënyrat e Tij i pështjelluan grekët, të cilët e vlerësonin kulturën si gurin e themelit të qytetarisë. Dhe Ai i mahniti hebrenjtë, të cilët jetonin me anë të respektimit të rreptë të Ligjit. Dhe hebrenjtë po ashtu nuk arrinin dot ta besonin që Mesia i tyre do të vdiste mbi një kryq.

Gjithashtu strategjia e Zotit tonë qëndron në kontrast të fortë me atë që gjejmë sot ndonjëherë në kishat tona. Disa bashkësi janë të dashuruara me koncepte udhëheqësish, të cilat i kanë huazuar nga sektori i korporatave. Duhet thënë që gjatë këtij procesi kemi zbuluar edhe disa pika të forta rreth udhëheqjes. Megjithatë, kanë dalë gjithashtu edhe disa nënprodukte të padëshiruara, siç janë imazhi, manipulimi dhe etja për pushtet. Disa kisha të tjera, në ekstremitetin tjetër, kanë zgjedhur kontrollin, gjendjen ekzistuese (*status quo*-në) dhe vjetërsinë, si cilësitë mbytëse që dëshirojnë më së shumti të shohin tek udhëheqësit që nuk janë pjesë e klerit.

Jezusi siguroi një mjekim mrekullibërës për të dyja këto ekstremitete që gjenden ndonjëherë në kishat e sotme. Kurdoherë që të Dymbëdhjetët bënin pyetje në lidhje me pozitën, pushtetin apo privilegjin, Mjeshtri e ndryshonte pa zhurmë bisedën për nga shërbimi, sakrifica dhe altruizmi ose harresa e vetes. Ai i mësoi ata, por na mësoi edhe neve, se kënaqësia që zgjat, gjendet atëherë kur e japim veten tonë në shërbim me bujari.

Zoti ynë i bëri thirrje dëshirës së brendshme të dishepujve, një dëshirë e zjarrtë që është pjesë e çdo qenieje njerëzore, pra, dëshira për ta bërë jetën që të ketë vlerë. Ndërkohë që ata i përgjigjeshin thirrjes së

Siç mund ta shohim edhe nga një lexim i shpejtë i historisë së Kishës së hershme, ky premtim u kthye në një fakt historik. Ndërkohë që Krishterimi marshon përgjatë faqeve të librit të Veprave të Apostujve, vihet re sesi Kisha i përshtaste strukturat e saj organizative ndërsa rritej nga 12 në 120, e më pas në mijëra besimtarë të rinj. Por edhe pse strukturat organizative ndryshuan për të pasur më shumë efikasitet, ato nuk i zvogëluan kualifikimet frymërore për udhëheqës potencialë nga radhët e besimtarëve të thjeshtë. Askund tjetër nuk janë përmendur më saktësisht dhe më qartësisht kualifikimet sesa tek Veprat e Apostujve 6, i cili është një pasazh që përshkruan përzgjedhjen e grupit të parë të udhëheqësve nga radhët e besimtarëve të thjeshtë.

Lista e kualifikimeve të nevojshme përfshinte besimin, urtësinë, ndershmërinë dhe të qenit të mbushur me Frymën e Shenjtë. Vini re se grupi i parë prej shtatë vetash u zgjodh për të shërbyer, jo për të vendosur. Detyra e tyre e parë ishte që të shtronin tavolinat, ndërsa e dyta ishte që të ndihmonin me zgjidhjen e ankesave mes të vejave të kishës.

Çuditërisht, dy prej këtyre të shtatëve që u zgjodhën për të shtruar tavolinat e për të zgjidhur keqkuptimet, e gjetën veten shumë shpejt në zemër të betejës. Stefani u bë martiri i parë. Dëshmia që ai dha para ekzekutimit të tij ka ndikuar mbarë botën për breza të tërë përmes konvertimit të Saulit të Tarsit. Filipi i ekspozoi ndaj ungjillit botët e samitanëve dhe etiopasve. Njëra pas tjetrës, fitoret vazhdojnë përmes faqeve të librit të Veprave të Apostujve ndërkohë që të krishterët e shekullit të parë bëjnë punën e Perëndisë që nga Jerusalemi, në Jude, në Samari e deri në skajet e dheut, ashtu si i porositi Jezusi.

Për kishat dhe shërbesat tona, na duhet të bëjmë disa pyetje urgjente: Si i flet veprës së kishës së sotme mënyra dinamike se si Jezusi i trajnoi dhe i mblodhi dishepujt e Tij? Si ia bëri Ai? Dhe si mund të mësojmë ne prej Tij? Për ta vënë në zbatim në mënyrë më specifike, po në ditët e sotme, si munden pastorët që të zhvillojnë udhëheqës nga radhët e besimtarëve të thjeshtë?

PËRDORNI TË VËRTETËN DHE HIRIN PËR T'Ë AFRUAR NJERËZIT TEK KRISHTI

Jezusi i tërhoqi njerëzit drejt vetes përmes të vërtetës, hirit, sakrificës, altruizmit dhe shërbimit. Dashuria e Tij vetëmohuese i joshi njerëzit; ngrohtësia e Tij i tërhoqi ata si një magnet. Ashtu si çdo brez për më shumë se 2000 vjet, afrimi pranë Jezusit prodhon një “sëmundje” frymërore gjithëse që quhet *shërbim*.

Por ndryshe nga shumë organizata laike, kisha ka edhe burime të paprekshme, të cilat e bëjnë atë unike, kuptimplotë dhe ndryshe nga çdo organizatë tjetër në botë. Edhe pse këto burime të paprekshme nuk shfaqen kurrë në raportet e buxhetit, në bilance apo kalendarë, ato janë mes realiteteve më reale në punën e Perëndisë. Këto realitete duhet të përshkruhen, të përkufizohen, të ushqehen dhe të vihen në zbatim tek e gjithë shërbesa e kishës, veçanërisht për zhvillimin e udhëheqësve që nuk janë pjesë e klerit.

MBANI GJALLË CILËSINË E NJERËZVE PËR TË QENË UNIKË

Jezusi zgjodhi dishepuj të cilët kishin dallime të jashtëzakonshme në personalitete, në perspektiva dhe në kualifikimet e tyre.

Për fat të keq, shumë grupe vendimmarrëse në kishë sot e shohin rolin e tyre nga pikëpamja e një bordi drejtorësh të një korporate dhe jo si një skuadër pelegrinësh frymërorë.

Sot, çdo pastor ka përgjegjësi të dyfishtë, si bari i njerëzve dhe si kreu i kishës së tij. Dhe midis këtyre të dyjave nuk duhet të ketë konkurrencë. Është e qartë se një pastor nuk mund ta lejojë përgjegjësinë e tij karshi njerëzve që të lihet pas dore nga kërkesat institucionale të një kisha. Por, po ashtu, pastori nuk mund të lejojë as kishën institucionale që të anashkalohet apo të shkatërrohet.

Zgjedhja nuk është midis individit apo institucionit, por se si t'i bëni individin dhe institucionin të fortë dhe të shëndetshëm në mënyrë që të jenë reciprocikisht të dobishëm për njëri-tjetrin. Është e nevojshme të thurim dashurinë, hirin, besimin, sakrificën dhe shërbimin në stofin e gjithçkaje që bën kisha, veçanërisht në detajet e punës së grupit vendimmarrës.

MAKSIMIZONI NDIKIMIN E BURIMEVE TË PAPREKSHME

Kisha ka burime të prekshme, të cilat duhet të menaxhohen si duhet. Shembuj të këtyre burimeve janë paratë, prona dhe personeli. Kisha duhet të pastrohet, duhen të mirëpriten personat që vijnë për herë të parë dhe duhet të paguhet faturat.

Shihni pak larminë tek Shkrimi: Pjetri ishte një reaktor bërthamor i nxehtë, një personazh të cilit i fliste goja përpara mendjes. Gjoni kishte një mentalitet gjykues, por më pas u quajt shumë i dashur. Mateu ishte një tagrambledhës i urryer. Thomai u quajt dyshuesi. Andrea tregoi tiparet e një ungjilltari të druajtur e personal.

Secili dishepull kishte një funksion të veçantë e të rëndësishëm. Së bashku, dishepujt përbënin një skuadër me aftësi plotësuese, aftësi të cilat e ndikuan botën e tyre për ungjillin. Ky grup i mrekullueshëm e i larmishëm është një demonstrim i qartë se Jezusi i çmon së tepërmi individët.

Apostulli Pal, i cili kishte përvojë me njerëz që ishin të vështirë për t'u udhëhequr, shpjegoi se si të qenit unik dhe uniteti kombinohen së bashku për të forcuar punën e një kisha: “...që të mos kishte përçarje në trup, por të gjitha gjymtyrët të kenë të njëjtin kujdes për njëra-tjetrën. Dhe nëse vuan një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët vuajnë bashkë; kurse po të nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të. Dhe ju jeni turpi i Krishtit dhe gjymtyrët e tij, veç e veç” - 1 Korintasve 12:25–27.

Ndoshta këto ndryshime janë pjesë e strategjisë së Zotit tonë për të na ndihmuar të kuptojmë që dhuntitë plotësuese e bëjnë kishën të fortë, të shëndetshme dhe efikase. Pitër Drakër (Peter Drucker), autor dhe drejtues manaxherial, e shtjellon edhe më tej këtë ide kur thotë që: –Një gabim i zakonshëm është besimi që, për shkak se individët janë të gjithë pjesë e të njëjtës skuadër, atëherë ata të gjithë mendojnë njësoj. Por nuk është kështu. Qëllimi i një skuadre është që t'i bëjë pikat e forta të çdo personi, efikase, ndërsa dobësitë e tij ose të saj, të papërfillshme".¹

kur udhëheqësve nga radhët e bashkësisë u tregohen mundësitë dhe u mësohen detyrimet e pjesës shërbyese të udhëheqjes, atëherë ata ndjejnë një nevojë brenda vetes për të themeluar një lidhje më të ngushtë e personale me Jezusin.

Një pastor, për të pasur përdorimin maksimal të dhuntive dhe aftësive plotësuese, mund të marrë në konsideratë këtë këshillë nga Xho Torre (Joe Torre), menaxher i bejsbollit profesionist: –Duhet të matni pulsën e lojtarëve tuaj, që ta dini se kush ka dhe kush nuk ka nevojë për vëmendje personale më të thellë, ose kush ka dhe kush nuk ka nevojë për trajnim, ose kush ka dhe kush nuk ka nevojë për një dialog vetëm për vetëm me ju, ose kujt t'ia besoni dhe kujt të mos ia besoni pjesët e vështira të lojës".²

Dinamika që e bëri këtë të funksiononte afër agimit të historisë së krishterë ishte e përqendruar tek Jezusi, i cili e tha të vërtetën dhe e tregoi atë edhe me veprat e tij. Por kishte edhe më tepër akoma; për të huazuar një frazë nga trajneri Vins Lombardi, Jezusi e kuptoi dhe e përdori faktin se –veprat e një udhëheqësi flasin". Ashtu si Zoti ynë, edhe fjalët e pastorit duhet të jenë të vërteta dhe ai duhet të veprojë me vërtetësi sipas fjalëve të tij, si dhe duhet të mbajë gjithmonë mend se veprat e tij flasin.

Të gjithë në bashkësi i kanë sytë e tyre tek pastori. Pothuajse gjithçka që bën ose thotë një pastor dërgon një mesazh të fortë rreth asaj që ai beson dhe asaj që është e rëndësishme për të.

VINI NË PËRDORIM MUNDËSITË E TRAJNIMIT

Kontrollojeni përsëri historinë biblike për të parë se ç'lidhje kishte Jezusi me dishepujt e Tij. Ai i pa ata

përmes syve të potencialit, dhe në majë të listës së tij të prioriteteve qëndronte pikërisht zhvillimi i potencialit të tyre. Si rrjedhojë, Jezusi ishte gjithmonë duke i mësuar dishepujt e Tij se si të jetonin, si të silleshin me njëri-tjetrin dhe se si ta fitonin botën. Jezusi e përdori shërbesën aktive për t'i zhvilluar dishepujt e Tij. Ai u bëri trajnim intensiv në vendin e punës. Ai foli me ta, u lut me ta, i inkurajoi, i paralajmëroi dhe i sfidoi; ai u kujdes për ta dhe iu besonte atyre. Jezusi formoi perspektivat e tyre dhe i forcoi shpirtat e tyre. Ata e panë dashurinë që Ai kishte për njerëzit.

Ata mësuuan shumë prej marrjes së shërbesës së Tij, e cila pati një efekt personal mbi ta, efekt të cilin nuk do të mund ta merrnin dot në bankat e një shkolle.

Shpeshherë Jezusi dha mësim, dhe dishepujt studiuan, nëpër faqe kodrash, ndërsa udhëtonin rrugës dhe në brigje liqeni ose deti. Ndërkohë që ata udhëtonin së bashku, Jezusi nuk rreshti së përsërituri mësimet rreth bazave të dashurisë, faljes, transformimit, varësisë tek Perëndia dhe jetesës me shenjtëri. Kur Jezusi i çoi në Gjetsemani, në Golgota dhe tek varri i boshatisur, Ai e tendosi qëndrueshmërinë e tyre frymërore pothuajse deri në pikën ku nuk mbanin më.

NJERËZ MË TË MIRË DO TË THOTË KISHA MË TË FORTA

Jezusi zhvilloi njerëz të guximshëm nga ana frymërore dhe më pas i përdori ata si personelin kyç për punën e ungjillit. Për fat të keq, shumë grupe vendimmarrëse në kishë sot e shohin rolin e tyre nga pikëpamja e një bordi drejtorësh të një korporate dhe jo si një skuadër pelegrinësh frymërorë. Si rrjedhojë, disa kisha menaxhohen si sipërmarrje tregtare; atëherë kisha kthehet në një organizatë njerëzore në vend që të jetë një organizëm i shenjtë. Në këtë ambient, shpesh dikush zgjidhet që të udhëheqë në bazë të njohurive që ka marrë, njohjeve që ka apo të gjërave që zotëron, në vend të asaj se kush është ose se kush mund të bëhet. Ndonjëherë udhëheqësit nga radhët e bashkësisë e shohin veten e tyre, gabimisht, sikur mbajnë një ofiq në vend që të jenë shërbëtorë të Zotit dhe të kishës së Tij.

Rezultatet mund të jenë të frikshme kur një kishë kthehet në një makinë të lubrifikuar mirë, e cila më shumë bën vepra të mira në vend që të bëhet një forcë shpenguese që ofron transformim të mbinatyrshëm. Ose, në aranzhime të tjera, kisha mund të kthehet në një market lagjeje ku të gjithë e njohin njëri-tjetrin, në vend që të bëhet një stacion shpëtimi për personat e zhytur në dëshpërim dhe trishtim të madh.

Por situata nuk ka pse të jetë kaq e zyrtë. Shpeshherë kur udhëheqësve nga radhët e bashkësisë u tregohen mundësitë dhe u mësohen detyrimet e pjesës shërbyese të udhëheqjes, atëherë ata ndajnë një nevojë brenda vetes për të themeluar një lidhje më të ngushtë e personale me Jezusin. Aventura të reja e të mrekullueshme zënë fill në jetën e tyre të brendshme, ndërkohë që i afrohen më shumë Atij. Si rrjedhojë, ata shpesh përfetojnë një pikëpamje që jep

HAPAT E RIPRODHIMIT TË STRATEGJISË SË JEZUSIT PËR NDËRTIMIN E SKUADRËS

Konferencë vjetore e zhvillimit të udhëheqjes

Vendosni në kalendarin e kishës një eveniment vjetor për zhvillimin e bashkëpunëtorëve. Inkurajojini të gjithë që të marrin pjesë.

Vendoseni zhvillimin e bashkëpunëtorëve në kalendarin e punëve

Investoni 30 minuta për zhvillimin nga secili takim mujor i bashkëpunëtorëve. Kjo do të rezultojë në fitime të mëdha për vite e vite me radhë.

Predikoni zhvillimin e bashkëpunëtorëve

Shkrimi ofron shumë shembuj, duke përfshirë Jezusin, Moisiun, Jozueun, Jozefin, Gjonin, Pjetrin dhe Palin.

Ndani dëshmi personale

Flisni shpeshherë nga podiumi për mënyrën se si po ju formon Perëndia juve si një udhëheqës i krishterë. Dëshmitë personale janë edhe më efikase kur ndahen në grupe të vogla.

Dhuroni libra

Disa do të lexojnë libra dhe do të fitojnë nga kjo përvojë. Disa të tjerë, nuk do t'i kapin me dorë librat që do t'u jepni. Por gjithsesi, një libër në shtëpinë, zyrën apo biznesin e tyre shërben si një kujtesë që zhvillimi i udhëheqjes pritet prej tyre si dhe vlerësohet.

Kaloni kohë me rrethin e brendshëm

Caktoni takime të rregullta me lojtarët kryesorë. Kur të jeni bashkë me ta, ndani ide, programe dhe ëndrra. Një orë gjatë drekës shpesh mund t'i revolucionarizojë njerëzit dhe të shkaktojë tek ata ndjenjën për të mbështetur një projekt.

Kontrolloni strategjitë tuaja

Rilexoni tek ky artikull paragrafin me titull: "Mbani gjallë cilësinë e njerëzve për të qenë unikë", i cili merret me thënien e të vërtetave, me veprimet që bëhen sipas

fjalëve dhe me vepra që flasin. Një udhëheqës udhëheq, veçanërisht në karakter dhe në besim.

Shihni potencial

Shihni dhe shprehni idetë tuaja rreth potencialit të njerëzve që janë në grupin tuaj të vendimeve dhe kudo në kishën tuaj.

Trajnioni, mentoroni, stërvitni dhe kërkoni mbështetje

Bëni herë pas here biseda personale me secilin anëtar të grupit të vendimeve. Shpjegoni nevojën dhe planin për zhvillimin e bashkëpunëtorëve.

Promovoni shërbimin si një mundësi për t'u rritur

Përfitimet e shumta personale të shërbimit të krishterë diskutohen shumë rrallë. Shumë shërbëtorëve të kishës nuk iu janë kujtuar asnjëherë përfitimet dhe kënaqësitë.

Praktikoni modelin e Jezusit për zhvillimin

Jezusi shfrytëzoi çdo rast bashkëbisedimi dhe shërbese për t'i zhvilluar dishepujt. Ai vuri në praktikë idenë se çdo situatë e ka një potencial për të mësuar diçka të re rreth shërbesës.

Rrisni shpirtin tuaj ndërkohë që po zhvilloni të tjerët

Mësimdhënia, udhëheqja dhe predikimi ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për veten tuaj në mënyrë që të mësoni. Përdorini ato dhe ua thoni edhe njerëzve tuaj.

Vini theksin mbi sinergjinë dhe zotërimin

Sinergji do të thotë se dy vetë mund të bëjnë më shumë se dyfishi i asaj që mund të bëjë një i vetëm. Zotërim do të thotë se personat punojnë mbi një ide derisa të ndajnë se kanë një interes që u është akorduar për një plan ose projekt.

NEIL B. WISEMAN

maksimumin për të tjerët, një ndjenjë përmbushëse rreth përkatësisë së tyre, një krijimtari imagjinare, një energji të shenjtë, një ndjenjë partneriteti me Perëndinë dhe një vetëbesim se pengesat mund të kapërcehen.

Marrëdhënia që kanë me besimtarët e tjerë dhe lidhja e ngushtë që kanë me Jezusin e bëjnë udhëheqësin nga radhët e bashkësisë një njeri më të mirë dhe një të krishterë më të fortë. Ushtrimi dhe disiplina forcon qëndrueshmërinë e tyre frymërore. Ata ndihmojnë në krijimin e presionit pozitiv nga bashkë-besimtarët, gjë e cila i inkurajon të tjerët të ngulmojnë në detyrën e tyre. Ata rriten në imazhin e Krishtit. Dhe, personat e botës tërhiqen drejt kishës.

Të shërbyerit në një grup vendimarrës në kishë mund t'i transformojë individët në mënyrë radikale nga spektatorë në lojtarë skuadre dhe nga kritikë në mbështetës.

FRYMËZONI ME QËLLIM

Në shoqërinë perëndimore, pasi t'u jenë përmbushur nevojat e ushqimit, strehimit dhe veshmbathjes, njerëzit duan të dinë nëse jetët e tyre kanë kuptim, nëse ata vlejnë për diçka, nëse ia vlen të jetojnë. Hulumtuesit Riçard Lajdër (Richard Leider) dhe Dejvid Shapiro (David Shapiro) dalin në konkluzionin: "Për shumicën e njerëzve, një jetë e jetuar pa kuptim është një frikë e tmerrshme".³

Jezusi iu përgjigj pyetjes rreth kuptimit të jetës me një përmbledhje shumë koncize: "Unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk" - Gjoni 10:10. Ndërkohë që Jezusi po i zhvillonte dishepujt e Tij në të krishterë të mirëfilltë e të shëndetshëm, Ai po i përgatiste ata që të themelonin Kishën e hershme. Jezusi u tregoi atyre dashurinë **agape**. Ai u dha mundësi për t'u rritur, për t'i vënë në provë talentet e tyre, për t'ia dalë mbanë, për të bërë gabime, dhe madje për ta turpëruar veten e tyre. Ai dukej i gatshëm për të bërë pothuajse gjithçka me qëllim që t'i ndihmonte ata të kishin sukses.

JEPUNI NJË MISION TË PËRMASAVE TË PERËNDISË

Ky koncept në kohën e Jezusit ishte radikal dhe vizionar. Mendoni pak për këtë, një mësues shëtitës që sfidonte një grup të vogël ndjekësish të zakonshëm për të fituar botën. Herë pas here, ndjekësit e Jezusit duhet të jenë kthyer nga njëri-tjetri dhe të kenë pyetur: "Vallë a e di Ai se kush jemi ne? Duhet që patjetër të jetë duke e ekzagjeruar. Askush nuk e ka fituar ndonjëherë të gjithë botën".

Megjithëse ishin vetëm 11 dishepuj pas tradhtisë së Judës, Mjeshtri i tyre u dha Porosinë e Madhe. Bashkë me atë detyrë, Ai u premtoi se do t'i fuqizonte dhe se do të ishte me ta, madje deri në fund të kohërave (Mateu 28:18-20). Njëmbëdhjetë plus Një i bëri ata aq të pathyeshëm në përhapjen e ungjillit sa që bota nuk ka qenë më njësoj që atëherë.

Ky është modeli i Zotit tonë për atëherë dhe për tani. Ai i jep kishës së Tij një detyrë kaq të madhe, sa që kërkohet përpjekja e tyre më e mirë për të dhënë maksimumin plus varësinë me gjithë zemër tek Perëndia. Fitimi i rastësishëm vetjak është që, dishepujt në atë kohë dhe udhëheqësit e zakonshëm sot, zhvillohen në aspektin frymëror ndërkohë që fuqizimi i Tij hyjnor vepron përmes tyre.

PRISNI KONFLIKTE

Ungjilli, për nga vetë natyra e tij, krijon konflikte. Ai u bën gjithmonë thirrje njerëzve që të ndryshojnë, dhe ndryshimi shpesh shkakton rezistencë, dhe rezistenca prodhon konflikt. Kështu ungjilli e zëvendëson të vjetrën me të renë, zëvendëson mëkatën me shpëtimin, gjendjen ekzistuese me transformimin, errësirën me dritën, prishjen me plotësinë, dhe lista mund të vazhdojë pafundësisht. Ndryshime të tilla drastike do ta shqetësojnë dikë, të jeni të sigurt. Pastorët duhet të sigurohen që konflikti të rrënjoset tek ungjilli, në vend që të jetë i rrënjosur në mendimin e tyre apo në nevojën e tyre të madhe për të pasur kontroll.

Konflikti i shkaktohet nga kërkesat e ungjillit duhet të jetë i mirëpritur dhe i zgjidhur. Objektivi është që të menaxhohet konflikti në mënyrë që të jetë krijuar dhe i dobishëm, jo shkatërrimtar. Njerëzit duhet të jenë të lirë të ngrihen për atë që besojnë, me kusht që këtë ta bëjnë në përulësi dhe me respekt për të tjerët.

Shpesh udhëheqësit shqetësohen në mënyrë të panevojshme për konflikte të mundshme. Shumë nga çështjet që mund të supozohet se e dëmtojnë një kishë ndodhin shumë rrallë. Duhet marrë në

konsideratë këshilla e Calvin Coolidge, i cili thotë: –Mos dil asnjëherë të përballësh me problemin. Nëse do të rrini të ulur, në nëntë nga 10 raste, dikush do ta kapi problemin përpara se të arrijë tek ju”.⁴

BËJENI GRUPIN VENDIMMARRËS NJË MIQËSI DASHAMIRËSE

Në kishën vendore, dhe sidomos në mesin e vendimarrësve, shumica e çështjeve vërtitet rreth marrëdhënieve njerëzore. Pjesë e procesit që përdori Jezusi për t'i bërë gati dishepujt e vet për largimin e Tij, ishte që t'u tregonte atyre se si ta donin njëri-tjetrin dhe si ta donin Atë më mirë. Ai i mësoi ata se dashuria është përbërësi kryesor i gjithçkaje që bën kisha. Dashuria i lidh njerëzit me Zotin. Dashuria është forca motivuese në çdo kishë efikase. Dashuria i anashkalon të metat dhe dështimet. Dashuria i trajton të tjerët ashtu siç duam edhe ne të trajtohemi. Dashuria i tërheq njerëzit tek Zoti. Dashuria është karakteristika dalluese bazë e kishës së Dhjatës së Re.

Kur i kërkuam që të citonte urdhërimin më të madh, Jezusi u përgjigj: —Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, dhe me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde. Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: Duaje të afërmin tënd porsì vetveten. Nga këto dy urdhërimet varet i tërë ligji dhe profetët” - Mateu 22:37–40.

Miku im e përmbloodhi më së miri:
“Dashuria e Kalvarit
shkrin ashpërsinë, ushqen faljen,
shëron marrëdhënien,
krijon miqësi, dhe ndez dëshminë”.⁵

Në një kohë kur nevojat dhe idetë për marrëdhënie janë shumë të përhapura, kisha duhet të jetë kisha. Klithma për komunitet ka arritur një ngazëllim ekstrem, veçanërisht në mesin e atyre që janë nga brezi i viteve 80-90 ose edhe më të rinj. Fjalë të tilla si: *marrëdhënie, familje, përkatësi, shtëpi, miqësi, komunitet, punë në skuadër, bashkësi, pranim dhe harmoni në unitet* duhet të jenë gjuha e përditshme e një kisha efikase. Kisha duhet të ketë dashuri për atë

që Zoti ka dashuri, pra, për të gjithë pa përjashtim. Duhet ta pranojë dashurinë e Atit si një udhërrëfyes për të jetuar. Duhet ta dojë Zotin, dhe popullin e Tij dhe botën e Tij.

Shkrimi është i qartë, i ngrohtë, mbështetës dhe qetësues gjithashtu, kur Jezusi na kujton se sa e rëndësishme është dashuria në kishë: –Nëse ndokush më do, do ta mbajë fjalën time; edhe Ati im do ta dojë dhe ne do të vijmë tek ai dhe do të bëjmë banesën tek ai” - Gjoni 14:23.

NEVOJA E JASHTËZAKONSHME QË PASTORËT TË ZHVILLOJNË UDHËHEQËS NGA RADHËT E BESIMTARËVE TË THJESHTË

Siç e kemi parë deri tani, mënyra si e ndërtoi Jezusi kishën e Tij ishte duke ngritur dishepuj të fuqishëm dhe më pas, përmes tyre, të ngrinte Kishën. Që kjo ide të vihet në zbatim në një bashkësi vendore nuk do të mjaftojë vetëm ofrimi i disa sesioneve trajnuese administrative. Por do të duhet që pastori të bëjë gjithçka që është e mundur për t'i ndihmuar anëtarët e grupit vendimarrës që të bëhen modele të mirëfillta të Kishës brenda kishës.

Por në mënyrë që kjo gjë të ndodhë, duhet që në fillim të pranohet dhe të zgjidhet një dilemë pështjelluese. Shpesh, për të shërbyer në borde dhe komitete kyçe përzgjidhen disa njerëz të cilët nuk e kanë idenë se si duhet të jetë kisha. Ata përpiqen të drejtojnë diçka që nuk kuptojnë.

Ekzistojnë disa shkaqe të mundshme për këtë. Shumë prej tyre shërbejnë nëpër kisha që janë të përkushtuara ndaj shumë gjërave të mira, mirëpo neglizhojnë qëllimin e tyre ose arsyen e ekzistencës së tyre. Disa bashkësi të tjera i caktojnë shumë herët të konvertuarit e rinj në pozicione kyçe, shpeshherë për shkak se ata më të vjetrit janë të lodhur, të mërzhitur apo të plogësht. Disa kisha udhëhiqen nga pastorë të cilët nuk e shohin nevojën për të zhvilluar udhëheqës. Kushdo që është i gatshëm të vijë në disa takime është mirë boll. Disa kisha ofrojnë mundësi trajnimi të formalizuara pa u marrë më parë me përkushtimin dhe pastërtinë vetjake, dhe kështu, ato kanë efikasitet pa vërtetësi frymërore. Por ka edhe të tjerë që besojnë se udhëheqësit nga radhët e bashkësisë do të ofendoheshin nëse mbi ta do të ngriheshin pritshmëritë për t'iu përkushtuar zhvillimit dhe rritjes, si një kusht për rolin e tyre si udhëheqës. Si rrjedhojë, pështjellimi (konfuzioni) mbretëron në më shumë vende nga sa duhet.

Një mënyrë e mirë për ta zgjidhur këtë lëmsh është duke përsëritur ose rishikuar atë se çfarë duhet të jetë kisha. Midis metaforave më të fuqishme tek Shkrimi gjejmë frazën përshkruese të Palit: “trupi i Krishtit” (1 Korintasve 12:27; Efesianëve 4:12). Vini re: jo thjesht trupi, por trupi i Krishtit.

Pali gjen gëzim në shërbesën plotësuese të të gjithë gjymtyrëve të trupit të Krishtit, kur shkruan se: “Prej të cilit gjithë trupi i bashkuar dhe i lidhur mirë, me anë të bashkimit të ndihmesës sipas masës së veprueshmërisë të çdo pjese të veçantë, shkakton rritjen e trupit, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri.” (Efesianëve 4:16, theksi është vendosur nga autori).

William Barclay, studiues i Dhjatës së Re, na e mpreh kuptimin tonë me këtë fjali frymëzuese: “Kisha është instrumenti, agjenti, arma, organizmi përmes të cilit duhen kryer qëllimet dhe planet e Jezu Krishtit. Pikërisht përmes kishës, Jezu Krishti kërkon t’u sjellë burrave dhe grave jetë, dritë dhe shpëtim. Në këtë qëndron lavdia e kishës, që kisha është instrumenti i nevojshëm në duart e Krishtit”.⁶ Trupi i Krishtit, ose siç mund ta quajmë disa persona, familja *agape* e Jezusit, kthehet në duart e Tij, këmbët e Tij, zëri i Tij dhe dashuria e Tij që vepron në botë. Dhe vini re rezultatet që na shpalosen në Shkrim: Trupi do të jetë i shëndetshëm, duke u rritur dhe plot me dashuri.

Perëndia, duke zgjedhur vetë që të punojë përmes kishës, i ka marrë pastorët dhe udhëheqësit nga radhët e bashkësisë dhe i ka bërë partnerët e Tij në punën e ungjillit. Jezusi, Mësuesi Mjeshtër, i mësoi dishepujt e Tij - dhe i mëson të gjithë ata që erdhën pas tyre - se njohuria pse shërbejmë në kishën e Tij dhe njohja se kujt i shërbejmë në kishën e Tij, janë barabar të rëndësishme me njohurinë se si të shërbejmë. Personi të cilit neve i shërbejmë është Jezusi. Arsyeja përse shërbejmë është që të ofrojmë jetë të re për këdo.

Në procesin e Jezusit për zhvillimin, tri çështje janë të qarta:

- (1) zhvillimi i udhëheqësve nga radhët e bashkësisë është i nevojshëm;
- (2) zhvillimi i udhëheqësve nga radhët e bashkësisë duhet të jetë i vazhdueshëm;
- (3) zhvillimi i udhëheqësve nga radhët e bashkësisë ka ndikim mbi personin që po trajnohet, kishën dhe jetën frymërore të pastorit apo trajnerit.

Shënimet

1. Cituar nga H. B. London dhe Neil B. Wiseman, *Becoming Your Favorite Church* (Ventura, Calif.: Regal, 2002), 40.
2. Joe Torre dhe Henry Dreher, *Joe Torre's Ground Rules for Winners: 12 Keys To Managing Team Players, Tough Bosses, Setbacks, and Success* (New York: Hyperion, 1999), 11, 12.
3. Sipas citimit tek libri nga Laurie Beth Jones, *The Path* (New York: Hyperion Books, 1996), x.
4. Shënim i Calvin Coolidge, cituar në librin nga Louis E. Boone, *Quotable Business* (New York: Random House, 1992), 85.
5. Paul S. Rees, “Lift Up Your Eyes — From Reporting to Interpreting,” *World Vision Magazine*, November 1973, 23.
6. William Barclay, *The Mind of Paul* (New York: Harper and Brothers Publishers, 1958), 248.



NEIL B. WISEMAN, është shkrimtar, folës dhe profesor. Ai gjithashtu shërben si themeluesi dhe drejtori i Institutit të Kishës së Vogël (Small Church Institute).



SI TË SHKËPUTEMI:

nga **Kujdestarë**
në **Pajisës**

Nga: **GREG OGDEN**



Reformimi Protestant premtoi një revolucion dhe murgu agustinian, Martin Luteri, ishte revolucionari i parë i tij. Luteri shpalosi pankartën në vijim kundër hierarkisë së kishës katolike të viteve 1500 dhe zënies së saj rob nga klerikët: “Përmes pagëzimit ne jemi të gjithë të shenjtëruar drejt priftërisë. Sepse kushdo që del nga uji i pagëzimit mund të mburret se është tashmë një prift, peshkop apo edhe papë i shenjtëruar”.¹ Ndarja midis klerit dhe popullit do të hiqej. Sistemi i vjetër i kastave dhe dallimi i klasave midis atyre që ishin të vajosur dhe atyre që nuk ishin të vajosur, do të ishte diçka e dalë mode. Pse? Dhjata e Re parashikon një priftëri universale, që i përfshin të gjithë ata që janë të pagëzuar në emrin e Jezu Krishtit (1 e Pjetrit 2:9; Zbulesa 1:6; 5:10).

Në çfarë pike jemi me përmbushjen e premtimit se të gjithë janë priftërinj përpara Perëndisë si edhe priftërinj për njëri-tjetrin? David Watson, në mënyrë profetike, shkroi: “Shumica e denominacioneve protestante kanë qenë po aq të mbizotëruar nga priftërinjtë, sa edhe katolikët. Është shërbestari, famulltari ose pastori, ai që i ka dominuar të gjitha takimet. Me fjalë të tjera, ndarjet mes klerit dhe popullit të thjeshtë kanë vazhduar në pothuajse të njëjtën mënyrë si në kohën e Para-Reformimit, dhe doktrina e dhuntive frymërore dhe e shërbesës së trupit kryesisht nuk është marrë fare parasysh”.²

Cila është prova për këtë? Kisha është krahasuar me një lojë futbollit me 20,000 spektatorë në stolat e stadiumit të cilët kanë një nevojë shumë të madhe për t’u ushtruar, por ata vetshikojnë 22 lojtarët në fushë, që kanë nevojë shumë të madhe për të pushuar. Kjo mendësi e spektatorit e shfaq veten në mënyrën se si njerëzit i përqasen adhurimit. Shumë adhurues besojnë se ata që janë në skenë duhet të ofrojnë një shfaqje angazhuese, kuptimplotë dhe argëtuese, ndërkohë që puna e adhuruesve qenkësh që të kritikojnë shërbesën e adhurimit.

Si arriti kisha deri në këtë pikë? Cilat janë arsyet për hendekun që ekziston midis premtimit biblik dhe historik të priftërisë universale dhe realitetit prej spektatori të jetës së përditshme kishtare? Ndoshta ne e valëvisim flamurin teologjik në favor të priftërisë së të gjithë besimtarëve, por unë kam bindjen se, pa dashje, ne kemi adoptuar një model varësie ndaj shërbesës pastorale, e cila ka krijuar pasivitet në mesin e popullit të Perëndisë. Ne duhet të zhvendosemi nga një model *varësie* drejt një modeli *ndreqës apo pajisës* të shërbesës pastorale në mënyrë që të shohim premtimin: „një anëtar, një shërbesë” teksa bëhet realitet.

PËRKUFIZIMI I MODELIT TË VARËSISË

Çfarë është modeli i varësisë? Pastorët merren me shërbesat dhe populli i Perëndisë merr kujdesin e tij pastoral. Kisha ka adoptuar, pa dashje, një model shërbesë të kujdestarisë profesionale, e cila ka rezultuar në pasivitet në mesin e popullit të Perëndisë. Shumica e pastorëve e dinë se një pjesë kryesore e punës së tyre është që t’u përgjigjen nevojave të anëtarëve dhe zgjedhësve të tyre. Në qoftë se dikush shtrohet në spital, ose vajton vdekjen e një të afërmi, ose është duke përjetuar një dështim jetëndryshues, ose është duke u përballur me vështirësi martesore, apo është duke u marrë me një fëmijë rebel, atëherë pastori supozohet që duhet ta ndihmojë. Kontrata emocionale midis pastorit dhe njerëzve në shumicën e kishave është: Në rast se dikush nga besimtarët ka ndonjë vështirësi, atëherë pastori pritet që të jetë aty për ta ndihmuar. Nëse pastori nuk vjen për të ofruar kujdes, ai ka dështuar

Cilat janë arsyet për hendekun që ekziston midis premtimit biblik dhe historik të priftërisë universale dhe realitetit prej spektatori të jetës së përditshme kishtare?

në bërjen e punës që pastorët duhet të bëjnë dhe ka dështuar edhe si pastor.

Pastorët janë kthyer në centralistë të ndihmës së parë. Një herë, drejtova një seminar dy ditor për pastore metodistë dhe vura re se pjesëmarrësit kishin ardhur të lidhur pas celularëve të tyre. Kur telefonat fillonin të dridheshin apo të lëshonin tinguj, pastorët kërkonin falje për t’u larguar nga takimi. Më vonë, pasi i ishin përgjigjur nevojës për të cilën ishin thirrur për të përmbushur, ata ktheheshin përsëri në takim.

NJË SISTEM FAMILJAR I PASHËNDETSHËM

Modeli i shërbesës së kujdestarit (ai që quhet modeli i varësisë) mund të krahasohet me një sistem familjar të pashëndetshëm. Prindërit, të cilët i mbajnë fëmijët e tyre gjithmonë nën kontroll e mbikëqyrje, dhe nuk i lejojnë kurrë që të zhvillohen në të rritur të përgjegjshëm, të dhimbsur dhe të pavarur, nuk shihen me sy të mirë. Kjo lloj familjeje nuk funksionon siç duhet. E megjithatë, ky është bërë një model i pashqyrtuar dhe i pranuar i shërbesës. Ne i paguajmë pastorët që të jenë kujdestarët frymërorë të fëmijëve të varur, të cilët kanë nevojë për një kujdes të vazhdueshëm. Si rrjedhojë, fëmijët mbeten të varur. Pastorët janë të zënë në kurth nga një set pritshmëri të gërshetua-

PRITSHMËRITË E NJERËZVE NGA PASTORI TË CILAT PËRFORCOJNË MODELIN E VARËSISË

Modeli i varësisë i shërbesës pastorale është veçanërisht i vështirë për t'u shkëputur për shkak se njerëzit e Perëndisë kanë pritshmëri për pastorët e tyre. Ekzistojnë po aq përkrahje pune për një pastor sa ka edhe besimtarë në një bashkësi. Këto zëra vorbullojnë në kokën tonë:

PASTORI YNË MUND T'I BËJË TË GJITHA

Kishat duan të jenë krenare për pastorët e tyre. Pastorët me shumë talente që janë drejtorë ekzekutivë, planifikues strategjikë, vizionarë, oratorë, barinj dhe kujdestarë janë të pakët dhe të rrallë. Këta janë ata të cilët kanë vendosur standardin me të cilin maten të gjithë pastorët. Çdo kishë dëshiron ta quajë veten me fat. Si sillen këto pritshmëri në kokën tuaj?

VETËM PASTORI MUND TË PRODHONË SHËRBIM TË VËRTETË

Kur vjen puna tek ofiqi i pastorit, ekziston tendenca për të krijuar një gjini të tretë, pra, burra, gra dhe pastorë. Pastorin e lidhim me një aureolë shenjtërie. Prekja plot kujdes e një pastori ka më shumë kuptim sesa ajo e një besimtari të zakonshëm. Pastorin e ndalojnë dhe i kërkojnë të lutet për një nevojë të veçantë sepse njerëzit supozojnë që ai ka një linjë direkte me Perëndinë. Kur një pastor ulet për të ngrënë një vakt në një rast në kishë, ata që janë tashmë të ulur thonë: "Sa të bekuar jemi që kemi pastorin në tavolinën tonë". Çfarë i bën kuptimit që ne kemi për shërbesën ky status i të qenit i veçantë?

UNË SHKOJ TEK KISHA E PASTOR FILAN FISTEKUT

Shpesh një kishë identifikohet me emrin e pastorit kryesor. Pastorët mund ta përforcojnë këtë duke thënë kisha "ime". Çfarë tregon kjo rreth kuptimit që kemi për kishën nëse përdorim përemra pronore kur i referohemi kishës dhe udhëheqësisë së saj njerëzore?

Greg Ogden, Oak Brook, Illinois

ra midis vetvetes dhe njerëzve të tyre, të cilat kanë qenë njësoj të dëmshme për të dyja palët. Si pastori, edhe njerëzit kanë hyrë njësoj në këtë komplot të varësisë.

Vetëm pastori mund të prodhojë shërbim të vërtetë

Një manifestim i këtij sistemi familjar të pashëndetshëm është edhe besimi që vetëm pastorët mund të prodhojnë një shërbim të vërtetë. Ekziston një besim i përhapur ndër shumë njerëz që pastorët e mbartin praninë e Krishtit më shumë sesa një besimtar i zakonshëm.

Xheri Kuk, një pastor në British Kolombia të Kanadasë, tregon historinë në vijim. Ai dëgjoi se një grua në bashkësinë e tij ishte e mërzhitur me të. Ajo kishte qenë në spital për 7 ditë dhe pastori nuk i kishte shkuar për vizitë. Pasi doli nga spitali dhe u kthye në shtëpi, pastori vendosi që ta merrte në telefon. Por përpara se ta merrte në telefon, ai bëri disa hetime dhe zbuloi që gjatë 7 ditëve që ajo ishte në spital, i kishin shkuar për vizitë mesatarisht 4 persona nga kisha në ditë. Më poshtë është biseda e tyre telefonike:

"Atëherë, si ndiheni zonja Bardha?"

Znj. Bardha iu përgjigj shkurt: "Po mirë jam tani".

Duke mos e marrë parasysh tonin e mprehtë të saj, Pastori Kuk vazhdoi: "Mora vesh që keni qenë në spital".

"Epo tani, është paksa vonë".

Pastor Kuk u përgjigj: "Paksa vonë për çfarë?"

"Unë isha atje për 7 ditë, dhe askush nuk më erdhi".

Pastor Kuk i përmendi vizitorët e shumtë që i kishin shkuar gjatë atyre ditëve. Pastaj ajo zbuloi bindjet e saj të vërteta: "Po, njerëzit nga kisha erdhën, por ti nuk erdhe".³

Cila është tragjedia e kësaj historie? A dështoi pastori të bënte punën e tij? Nuk do të ishte e saktë të thuhej kështu. Ai dhe të tjerët kishin krijuar një shërbesë të mobilizuar, dhe Znj. Bardha e kishte marrë kujdesin e duhur. Tragjikja këtu është që ajo kishte humbur praninë e Krishtit tek vizitorët e saj për shkak se besonte se vetëm pastori mund të jepte shërbimin e vërtetë. Shërbesa e mirëfilltë e popullit të Perëndisë u zvogëlua për shkak se ajo besonte që pastori mbante një pozitë më të lartë.

Nevoja për të qenë i nevojshëm

Ekstremi tjetër i besimit se vetëm pastori mund të prodhojë shërbim të vërtetë, është kur pastorët besojnë që ata janë të domosdoshëm. Një nga

profilat psikologjike për shumë pastorë është nevoja për të ndihmuar njerëzit. Nuk ka asgjë që nuk shkon me këtë, veç nëse kthehet në një nevojë të tepruar për t'iu bërë qejfin njerëzve.

Pas një vizite që i bëra një burri 75 vjeçar i cili ishte shtruar në spital pas një operacioni, mora letrën e mëposhtme. Me lot në sy, Tomi fliste i mallëngjyer rreth një takimi emocional dhe frymëror me Zotin ndërsa po përgatitej për operacionin e tij. Familja ishte e gatshme që të më jepte mua merita të jashtëzakonshme për këtë epifani.

I dashur Greg,

Edhe aq i zënë sa ishe, ti erdhe për t'iu bërë vizitë Tomit. Ne e konsiderojmë këtë një bekim të madh. Patjetër erdhën edhe shumë shenjtorë për vizitë, por gjithsesi vizita jote kishte më shumë kuptim.

Lutjet morën përgjigje përmes infermiereve, doktorëve dhe përmes teje. Tomi tani është më mirë.

Shijoj pushimet e tua të merituar.

Me dashuri,

Tomi dhe Evelina (këta nuk janë emrat e tyre të vërtetë)

Oh, çfarë çengeli emocional! “Edhe aq i zënë sa ishe”. Unë solla një bekim. Unë jam më i rëndësishëm se pjesa tjetër e shenjtorëve. Prerazi, Perëndia iu përgjigj lutjeve të mia. Tani unë mund të shkoj në pushimet e mia të merituar. Në mënyrë të paditur, këta njerëz të mrekullueshëm dhe të sinqertë po përforconin megalomaninë time (delirin tim të madhështisë).

Modeli i shërbesës së varësisë e shkatërron mësimin biblik që kisha është trupi i Krishtit dhe që çdo anëtar ka një rol të çmuar për të luajtur. Ne mund ta mbështesim me fjalë doktrinën e priftërisë tek të gjithë besimtarët, ndërkohë që po e mohojmë atë me mënyrën se si shërbejmë në kishën vendore. Ajo masë me të cilën i mbështesim pastorët si kujdestarë të autorizuar, me të cilën besojmë që vetëm ata mund të prodhojnë shërbim të vërtetë dhe i kthejmë në heronj kur na gjenden pranë në rastet kur kemi nevojë, është pikërisht masa me anë të së cilës ne krijojmë një sistem ku pastorët janë prindër autoritarë dhe njerëzit e Perëndisë janë përjetësisht fëmijë.

Edhe nëse pastorët duan të çlirohen nga ky sistem i pashëndetshëm, shumë pastorë i kthehen përsëri modelit të varësisë për shkak se ekziston një kosto shumë e madhe për t'iu paguar për të qenë një pastor

Synimi i Pajisjes: Priftëria e të Gjithë Besimtarëve Efesianët 4:11, 12




i cili i pajis të tjerët. Pastorët ndihen të zënë në lak nga pritshmëritë e njerëzve. Gjëja e fundit që ata duan, është që të dështojnë për të qenë në lartësinë e duhur të pritshmërive të ngritura. Rruga më e thjeshtë është që të dorëzohen ndaj presioneve të dëshirave të bashkësisë, në vend që të kalojnë përmes procesit të dhimbshëm të riedukimit.

Një model më i shëndetshëm e shikon pastorin jo si një kujdestar për ata që nuk mund të kujdesen për vetveten, por si një person i cili i pajis bashkëbesimtarët, i inkurajon njerëzit dhe ofron një kontekst për ta trajnuar popullin e Perëndisë për shërbesë.

NJË MODEL PAJISËS I SHËRBESES

Një përshkrim biblik i punës për pastorin gjendet tek Efesianëve 4:11, 12: “Dhe ai dha disa si apostuj, të tjerë si profetë, të tjerë si ungjilltarë, të tjerë si barinj e mësues, për ndreqjen e shenjtorëve, për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit”.

Pali e përkufizoi *ndreqjen* (në versionin e Biblës që përdor autori kjo fjalë përkthehet *pajis*, por në disa versione është përkthyer edhe *përsos* ose *përgatis – shënim i redaktorit në shqip*) në aspektin e rezultateve. Ndreqja ose pajisja ndodh atëherë kur shenjtorët (besimtarët e thjeshtë e të zakonshëm) bëjnë veprën e shërbimit dhe ndërkohë ndërtohet trupi i Krishtit. Pikërisht këtu Satani i devijon pastorët nga thirrja e tyre, për të adoptuar rolin bombastik të kujdestarit. Satani realizon një dredhi mjeshtërore. Ai i shpërqendron pastorët dhe mësuesit duke iu tërhequr vëmendjen larg nga ndreqja apo pajisja e shenjtorëve për shërbesë.



Një brez më parë, Elton Trueblood, një teolog i thjeshtë i denominacionit Quaker, shkroi librin "Miqësia ndezëse". Në këtë vepër, ai propozoi se pajisja ishte thirrja parësore e atyre që ishin në shërbesën pastorale. Fjala më poshtë është përmbledhja më e mirë që kam lexuar ndonjëherë e pikëpamjes së Dhjatës së Re për shërbimin: "Shërbesa është për të gjithë ata që marrin pjesë në jetën e Krishtit, pastorimi është për ata që zotërojnë dhuntinë e veçantë të të qenit në gjendje për të ndihmuar burra dhe gra për të praktikuar çdo shërbesë në të cilën janë të thirrur".⁵

Fjala *ndreq*, *përsos* ose *pajis* në greqisht (*katartismos*) është një fjalë udhëzuese. Një nga përkufizimet për të vjen nga termi mjekësor që përdoret për të përshkruar vendosjen në vendin e vet të një gjymtyre të thyer ose të një nyje lidhëse. Ndrejja përcjell kuptimin e riparimit të një pjese të trupit në mënyrë që ajo të funksionojë përsëri sipas qëllimit të duhur. Tek Marku 1:19, Jakobi dhe Gjoni janë duke riparuar rrjetat e tyre. Rrjeta e peshkimit është e dobishme vetëm nëse bën atë për të cilën është projektuar. Fjala *përsos* gjithashtu përdoret për një artizan i cili punon me duart e tij për të bërë diçka të dobishme apo të bukur. Pajisja nënkupton se shenjtorët kanë një funksion të veçantë ose një shërbesë të veçantë për të cilën janë të përshtatshëm.

Shërbesë nuk është ajo që bëjnë pastorët, por ajo që bëjnë njerëzit e Perëndisë. Pjesa e pastorit është që t'i ndihmojë gjymtyrët e Trupit duke iu dhënë atyre një dorë që të gjejnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në mënyrë që të mund të kontribuojnë për ndërtimin e trupit të Krishtit.

Për të përshkruar funksionin e një pastori pajisës karshi bashkësisë bashkëkohore, do të ishte e dobishme që të përdornim një imazh i cili e përkufizon marrëdhënien pajisëse (ndreqëse) midis pastorit dhe njerëzve. Trublad propozon dhe hedh poshtë disa alternativa. Nëse e quajmë pastorin *shërbestar*, kjo duket se e përjashton popullin e thjeshtë të Perëndisë, të cilët janë gjithashtu shërbestarë. Shkrimi e barazon pastorin me *një plak kishe*, por plaku nuk përshkruan funksionin. Termat *mbikëqyrës*, *bari* apo *pastor* përcjellin mbikëqyrje dhe mbrojtje frymërore të tufës, por jo fuqizimin e saj. Për këto arsye, Trublad guxon përtej gjuhës biblike dhe përdor një imazh të freskët për të përkufizuar funksionin e dikujt që pajis. Ai propozon imazhin e *trajnerit* si termi i barasvlershëm më i mirë modern. Por duke qenë se fjala *trajner* tingëllon sikur pastorët vetëm bërtasin me udhëzime nga vija anësore, ai shton edhe një mbiemër, pra, *trajner lojtar*. Me fjalë të tjera, pastorët pajisës hyjnë në partneritet me lojtarët besimtarë në lojën e shërbesës.

Një nga pasojat e nxitjes së pastorëve për t'u zhvendosur nga një model varësie i kujdestarisë, në një model ndreqës është se krijon një krizë identiteti. Në qoftë se pastori nuk është personi tek i cili njerëzit janë mësuar të mbështeten, atëherë kush është ai? Trublad e adreson këtë: "Ideja e pastorit si një pajisës është e tillë që është e mbushur plot premtim, duke u risjellë respektin për veten njerëzve në shërbesë, të cilët janë zhgënjyer shumë nga modeli i vjetër. Vëmendja ndaj fuqive të pazhvilluara, nxjerrja e tyre në pah, sjellja e potencialit në realitet në jetët njerëzore – kjo është një detyrë e vlefshmërisë së vetes".⁷

Më kujtohet ndikimi që pati termi *trajner* herën e parë që e përdora për të përshkruar rolin tim. Atëherë isha një ndihmës pastor. Titulli i saktë ishte Pastor për Zhvillimin e Udhëheqjes dhe të Dishepullizimit. Duke qenë se pajisja e njerëzve për shërbesë në fushat e grupeve të vogla, dhuntitë frymërore dhe dishepullizimit ishte pjesë përbërëse e përshkrimit tim të punës, unë po përpiqesha të përkufizoja identitetin tim të pajisjes. Pasi mbarova artikullin tim të parë të buletinit, e firmosa me fjalët: "Trajneri juaj, Gregu".

U befasova pak nga reagimi që shkaktoi termi *trajner*. Si fillim, njerëzit u argëtuan me të. Më rrahën shpatullat disa herë, të shoqëruar edhe me komente të tilla si: "Si është trajneri sot?".

Trajneri ishte qartësisht një imazh të cilin njerëzit mund ta identifikonin qartësisht. Gjithashtu ky term i theu barrierat klerikale. E megjithatë, një bashkë-

bisedim i veçantë e përforcoi idenë se sa shumë imazhi i trajnerit e përmbledh marrëdhënien midis pastorit dhe njerëzve.

Shirli, me entuziazëm të madh, m'u afrua dhe më tha: "Për ta sqaruar nëse e kam kuptuar si duhet, nëse ju jeni trajneri ynë, atëherë ne duhet të jemi në të njëjtën skuadër, apo jo?"

E sigurova që nuk ka dy skuadra, pra, nuk është një skuadër e klerit dhe një tjetër e besimtarëve të thjeshtë.

Ajo vazhdoi: "Në rast se ju jeni trajneri ynë, atëherë duhet të jetë përgjegjësia juaj që të më ndihmoni të zbuloj rolin tim në skuadër dhe të më ndihmoni ta zhvilloj atë. E drejtë?"

"Po, saktë", i thashë unë.

Imazhi i trajnerit sjell në realitet idenë se kisha, si trupi i Krishtit, është një skuadër në të cilën të gjithë lojtarët vlerësohen dhe ku të gjithë mund të japin një kontribut. Për këtë arsye, një kishë ku kam shërbyer në Kaliforninë e Veriut adoptoi si moton e saj shprehjen: "Në këtë skuadër luajnë të gjithë".

Cilat janë rrjedhojat e një modeli ndreqës (pajisës) për mënyrën se si kryhet shërbesa? Si e sjell modeli ndreqës priftërinë e të gjithë besimtarëve në lulëzim të plotë? Për ta sjellë një shërbesë ndreqëse në realitet, ajo duhet të ndikojë prioritetet pastorale, metodën e udhëheqjes si dhe strukturën e jetës së kishës.

Prioritetet

Në modelin e varësisë, pastori është personi parësor që iu përgjigjet nevojave pastorale të një bashkësie. I pyes shpesh pastorët se si përfundojnë njerëzit në kalendarin e tyre të takimeve. A kërkojnë aktivisht pastorët njerëz tek të cilët të bëjnë një investim të planifikuar apo njerëzit e vendosin vetë veten e tyre në kalendar për shkak se kanë një shqetësim për të cilin kanë nevojë për vëmendje? Si duhet ta kalojnë kohën e tyre trajneri me lojtarin? Ata duhet ta kalojnë kohën e tyre duke zhvilluar njerëz të cilët duan të jenë të angazhuar në shërbesë. Ky është rregulli im i pashkruar: 80 për qind e kohës së një pastori, përtej përgatitjes për të predikuar apo mësuar, duhet të shpenzohet me 20 për qindëshin e bashkësisë që kanë potencialin më të madh për shërbesë. Është një e vërtetë e padhunueshme që shërbesat tona do të kenë sukses vetëm përmes përpjekjeve të atyre dishepujve që janë iniciatorë dhe që nderojnë Krishtin.

Jezusi e modeloi dhe e kuptoi këtë më mirë se kushdo tjetër. Përse investoi Jezusi tek Të Dymbëdhjetët? Në fund të shërbesës së Tij tokësore, tek Gjoni 17:1-19, përse ishte lutja e Tij e fokusuar tek Të Dymbëdhjetët? Ai i trajnoi ata që ta vazhdonin shërbesën e Tij edhe pasi të ishte kthyer tek Ati. Sa strategjikë jemi ne me investimin e jetëve tona tek të tjerët?

PRITSHMËRITË E VETË OFIQIT TË PASTORIT QË E PËRFORCOJNË MODELIN E VARËSISË

Modeli i varësisë mban gjallë pritshmëritë që pastorët kanë për veten e tyre. Në qoftë se pastorët kanë pritshmëritë e mëposhtme për veten, atëherë ata janë duke e përforcuar modelin e varësisë.

GIJTHËKOMPETENCA

Kjo fjalë tregon se pastorët duhet të jenë të shkëlqyer në gjithçka, në rast se duan të jenë të efektshëm. Kjo do të thotë që një pastor i mirë duhet të jetë një komunikues i shkëlqyer, një administrator i mirë, një këshilltar me zemër të butë, një person me një tërheqje bombastike nëpër evenimente sociale, një strateg i rritjes së kishës, etj. Kështu, një pastor i shton presion vetes së tij për të qenë në gjendje që t'i bëjë të gjitha.

KONTROLLI

Robert Munger, pastori i ndjerë presbiterian, shkroi: "Pengesja e vetme më e madhe për ripërtëritjen dhe arritjen e kishës është ndarja e roleve midis klerit dhe besimtarëve të thjeshtë, e cila rezultoi në një hezitim nga ana e klerit për t'i besuar besimtarët e thjeshtë me përgjegjësi domethënëse, dhe si rrjedhojë një lloj ngurrimi nga ana e besimtarëve për të besuar tek vetja e tyre si

shërbestarë të mirëfilltë të Krishtit, qoftë brenda kishës, qoftë jashtë saj".

AUREOLË PRIFTËRORE

Pastorët ushtrojnë trysni mbi vetveten për të mbajtur një pamje të jashtme prej shenjtori. Disa pastorë janë trajnuar për të mbajtur një distancë profesionale nga besimtarët e tyre. Ndonjëherë pastorët supozojnë se nëse besimtarët e tyre i shohin të metat që kanë, atëherë ata do të humbasin pozitën e tyre të autoritetit.

NEVOJA E PASHËNDETSHME PËR TË QENË I NEVOJSHËM

Sidomos në fushën e kujdestarisë, pastorët mund të ushqejnë një varësi duke e mbajtur veten e tyre shumë të zënë e të lodhur, duke i adresuar të gjitha nevojat e perceptuara. Pastorët mezi presin që t'i dëgjojnë njerëzit të thonë: "Nuk do ta kisha kaluar atë krizë pa ty". Kështu, pa dashur e pa e kuptuar, identiteti i pastorit është ngritur rreth adhurimit të heroit, sikur ai të ishte shembulli i vetë Jezusit.

Greg Ogden, Oak Brook, Illinois

Metoda e udhëheqjes

Ekziston një metodë udhëheqjeje e cila është e qëndrueshme me fuqizimin e të tjerëve për shërbesë. Një udhëheqës që pajis ose ndreq, në radhë të parë është një person i vërtetë. Pastorët që pajisin zbresin nga piedestali, vijnë krah për krah me popullin e Perëndisë dhe e ndajnë udhëtimin me ta. Kushdo që ka qenë afër meje për njëfarë kohe, e di që ka pasur raste që unë jam paralizuar me frikë dhe ankth të pashpjegueshëm. Kaq shumë u përkeqësua gjendja ime, sa që kërkoja ndihmë nga personat në trupin e Krishtit që ushtronin dhuntinë frymërore të shërimit. A e zvogëlon kjo autoritetin tim? Aspak. Së pari, u tregojnë njerëzve që jam i gatshëm të bëj çdo gjë të mundur për të qenë personi i Krishtit dhe së dyti, njerëzit mendojnë: *“Ai përballat me të njëjtat vështirësi porsia unë. Në rast se ai mund t’u bëjë ballë, atëherë edhe unë mundem”*.

Përveç të qenit një person i vërtetë (i çiltër) me të tjerët, një pastor i cili pajis, gjen kënaqësi në nxjerrjen në pah të të tjerëve dhe në ndriçimin e prozhektorit të shërbesës mbi të tjerët. Një udhëheqës që pajis, kënaqet duke besuar dhe duke parë që shërbesa e të tjerëve po lulëzon dhe po jep fryt.

Unë jap mësim një lëndë bashkë me Çakun, një besimtar në bashkësinë tonë. Çdo javë njerëzit thonë: “Sa mësuesi i mirë është Çaku. Po ku e gjete?”. Unë mund ta interpretoj mbështetjen e tyre për Çakun si kritikë e nënkuptuar ndaj meje, ose pohimet e tyre mund të ushqejnë një dëshirë për të lakmuar të gjithë vëmendjen. Më mirë, unë zgjedh të ngazëllem që Çaku po shërben në një kontekst ku dhuntitë e tij shkëlqejnë.

Strukturë e decentralizuar

Një shërbesë ndreqëse (pajisëse) është një shërbesë e decentralizuar.

Grupet e vogla. Tek Eksodi 18, Jethro e udhëzoi Moisiun që ta qeveriste kombin e Izraelit duke vendosur udhëheqës besnikë e të aftë për të drejtuar grupe njerëzish me nga 1000, 100, 50 dhe 10 vetë. Është e vështirë të imagjinohet një shërbesë ndreqëse pa një strukturë me grupe të vogla ku besimtarëve të pajisur iu janë dhënë instrumentet dhe përgjegjësitë për t’u kujdesur për një grup prej 10 vetash. Udhëheqësi më i rëndësishëm në kishë nuk është pastori kryesor apo ndonjë nga stafi i kishës i cili paguhet, por është drejtuesi i një skuadre shërbimi ose i një grupi lagjeje prej 10 vetësh.

Zbulimi i dhuntive. Në një shërbesë ku është i përfshirë çdo anëtar, duhet theksuar gjithashtu fakti se i gjithë populli i Perëndisë është pajisur me dhunti dhe është i thirrur në shërbesë. Pavarësisht nëse keni një proces formal me klasa dhe trajnerë për t’i ndihmuar njerëzit që të jenë të qartë rreth asaj se me çfarë kontribuojnë, apo pavarësisht nëse procesi është i ndërtuar në psikikën e kishës suaj, duhet të ekzistojë një atmosferë ku jepet dhe merret leje, duke treguar se të gjithë janë të vlerësuar këtu.

Në një konferencë, një nga udhëheqësit tanë nga radhët e besimtarëve të thjeshtë përdori një shprehje që përmblodhi mënyrën se si duhet të funksionojë trupi i Krishtit. Ai tha: “Ne nuk i kemi të gjitha në vijë, por së bashku i kemi të gjitha”. Kjo nënkupton se të gjithë nevojiten. Perëndia u ka dhënë dhunti të gjithëve përmes Frymës së Tij. Secili person ka diçka për të ofruar.

Dishepullizimi. Rritja e njerëzve përmes dishepullizimit drejt pjekurisë duhet të jetë e qëllimshme. Kohën më të rëndësishme të javës e kaloj me tre burra të tjerë nga ora 7 deri në 8:30 të mëngjesit, çdo të mërkurë. Qëllimi ynë është të arrijmë pjekuri në Krishtin dhe ta pajisim veten tonë përmes shumëfishimit për të dishepullizuar të tjerët.

Kapitulli përmbysës i librit “Liberating the Laity” (Duke Çliruar Besimtarët) nga Howard Snyder është i titulluar “Pastorët: të lirë për të dishepullizuar”.



Snyder thekson se dishepullizimi është fokusi parësor i shërbesës së një pastori. Në thelb, prioriteti i parë i pastorit është që ta investojë veten e tij ose të saj kaq shumë tek disa persona të tjerë, sa që këta të fundit të jenë bërë gjithashtu dishepullizues dhe shërbestarë të Jezu Krishtit. Është pikërisht përmes dhënies së vetes ndaj të tjerëve dhe ndaj punës së dishepullizimit që norma e Dhjatës së Re për udhëheqje ose pleqësi të shumëfishtë kthehet në një realitet në bashkësinë vendore. Me fjalë të tjera, është për ta sjellë shërbesën e të gjithë popullit të Perëndisë në një realitet praktik e funksional”.⁸

PËRFUNDIMI

Më lejoni ta përfundoj përpjekjen time për të krahasuar modelin e varësisë me modelin e ndreqjes (pajisjes) duke ndarë me ju dëshminë e udhëtimit të një pastori që ishte një kujdestar i cili i bënte të gjitha, dhe u bë një udhëheqës që pajis. (Letrën në vijim e mora ndërkohë që isha drejtor i programit të doktoraturës së shërbesës. Ky pastor i referohet librit tim me titull “Unfinished Business” [Punë e papërfunduar], nga i cili rrjedhin mendimet e këtij artikulli).

“Në vitin 1998, dorëzova propozimin tim (për projektin përfundimtar) dhe ai u miratua. Më vutë në dukje që duhet të shtoja librin tuaj në bibliografinë time. Me emocion të madh, e bleva librin tuaj që atë ditë. Megjithatë, pasi e kuptova sfondin tuaj, emocionimi im i madh u kthye në zhgënjim. Unë doja ta shkruaja tezën time të diplomimit rreth pastorit omnikompetent (që mund t’i bëjë të gjitha). Por, libri juaj me ide radikale po më parandalonte.

Në atë kohë isha duke punuar 80 orë në javë duke bërë absolutisht gjithçka të mundur, brenda aftësive të mia, për të qenë një pastor i suksesshëm. E megjithatë, kisha nuk po rritej. Në fakt, po humbnim anëtarë dhe financa.

Në dhjetor të vitit 1999, isha në gjunjë duke i kërkuar Zotit që të më transferonte në një kishë tjetër, por Ai nuk e bëri këtë. Pas lutjes atë natë, zbrita në bodrum për të ndezur kaldajën. Po aty, sipër kaldajës, qëndronte libri juaj. E lexova atë natë të gjithë librin, ndërkohë që zemërimi më vlonte nga brenda, sepse po hidhni poshtë gjithçka që unë besoja se ishte biblike rreth shërbesës pastorale. Gjatë gjashtë ditëve në vazhdim e lexova librin katër herë, dhe çdo herë u ndjeva më mirë për mesazhin tuaj.

Për gati një vit e gjysmë kam qenë duke e vënë në zbatim librin tuaj në shërbesën time. Njerëzit në

kishë janë më të relaksuar. Tani që flasim, kemi 26 anëtarë të kishës që janë të përfshirë drejtpërdrejt me shërbesa të cilat para një viti do të kishin qenë rreptësisht fusha ime. Pjesëmarrja ka shkuar nga 70 në 180. Vetëm këtë vit, gjatë 6 muajve të parë, kemi pasur 21 pagëzime. Më është dashur një kohë e gjatë që ta përvetësoj mesazhin tuaj, por padyshim që ka qenë jetëndryshuese për mua”.⁹

Shënimet

1. Martin Luther, “The Babylonian Captivity of the Church,” *Works of Martin Luther* (Philadelphia: Westminster, 1943), 282, 283.
2. David Watson, *I Believe in the Church* (Grand Rapids: Eerdmans, 1978), 253.
3. Jerry Cook, *Love, Acceptance, and Forgiveness* (Glendale, Calif.: Regal, 1979), 102.
4. Ray Stedman, *Body Life* (Glendale, Calif.: Regal Books, 1972), 81.
5. Elton Trueblood, *The Incendiary Fellowship* (New York: Harper and Row, 1967), 41. Kursivi është i shtuar.
6. Greg Ogden, *Unfinished Business: Returning the Ministry to the People of God* (Grand Rapids: Zondervan, 2003).
7. Elton Trueblood, *The Incendiary Fellowship* (New York: Harper and Row, 1967), 41. Kursivi është i shtuar.
8. Howard Snyder, *Liberating the Church* (Downers Grove, Ill.: InterVarsity Press, 1983), 243. Për një eksplorim më të plotë të riprodhimit të dishepujve shihni Greg Ogden, *Transforming Discipleship: Making Disciples a Few at a Time* (InterVarsity Press, 2003), dhe kurrikulën e Greg Ogden për dishepullizimin të titulluar *Discipleship Essentials: A Guide To Building Your Life in Christ* (InterVarsity Press, 1998).
9. Përdorur me autorizimin e autorit



GREG OGDEN, është pastori ekzekutiv i dishepullizimit në Kishën e Krishtit në qytetin Oak Brook, Illinois.

DUKE ÇLIRUAR **KISHËN:**

**NJË PËRQASJE E
ORGANIZUAR**

Nga: **CRAIG E. SWEENEY**





Kishat të cilat i pajisin anëtarët e tyre nuk janë aksidente. Ato vijnë në këtë pikë si rezultat i lutjes, i planifikimit dhe i praktikës së qëllimshme e të paramenduar. Kur dikush dëshiron që të ndërtojë një shtëpi, nuk e fillon me planimetrinë e saj. Ai e fillon me ëndrrën e një shtëpie të caktuar.

Vetëm pasi të ketë marrë formë ëndrra, skicohen dhe zhvillohen planimetritë. Arkitekti vizaton një skicë për ta përdorur gjatë gjithë procesit si një imazh i cili i udhëheq projektuesit dhe ndërtuesit. Planimetritë japin udhëzime hap pas hapi për të ndërtuar shtëpinë e ëndrrave. Ndërtuesit i përdorin planimetritë dhe skicën shumë herë gjatë secilit stad të ndërtimit në mënyrë që shtëpia e ëndrrave të bëhet një realitet.

Edhe kishat nuk janë shumë ndryshe. Ato së pari u imagjinuan në zemrën e Perëndisë dhe më pas ëndrra e Tij mori formë. Apostulli Pal ndihmoi që të identifikonte formën e asaj që kishte imagjinuar Perëndia. Në letrën e tij drejtuar Efesianëve, Pali vizatoi një skicë të ëndrrës së Perëndisë për kishën e Dhjatës së Re (kapitulli 4). Vargjet janë të shkurtra, por skica (tabloja) ka thellësi të konsiderueshme.

Pali paraqiti një tablo të trupit të Krishtit që është duke gëluar me jetë dhe me shpresë, si dhe një trup i cili po i pajis njerëzit për thirrjet e tyre në mënyrë që të mund t'i bashkohen Perëndisë në planin që Ai ka për njerëzimin. Në të vërtetë, kjo është kisha e çliruar (e zgjidhur), duke përmbushur atë që vetëm Perëndia mund ta kishte përfytyruar.

Shumë vetë ndalen për të admiruar këtë portret të një kishe që arrin “në masën e moshës së plotësisë së Krishtit” (Efesianëve 4:13). Shpesh largohemi nga kjo tablo të frymëzuar nga mundësitë e saj të pafund, por ndihemi të pa aftë për të rikrijuar intensitetin e saj të jetës, gjallërisë apo aftësisë për të pajisur në kishat tona.

Duhet të bëjmë pyetjen: A është e mundur sot që të kemi një kishë pajisëse e cila gëlon me këtë lloj jete dhe shprese? A mos vallë Pali na paraqiti një tablo që nuk ishte realiste?

AKSIDENTI NUK DO TË NDODHË VETVETIU

Është e mundur që të jemi kisha e ëndrrave e përshkruar tek Efesianëve 4, por kjo nuk do të ndodhë aksidentalisht. Pastorët duhet t'i mbajnë sytë e tyre, në çdo etapë, tek ëndrra. Ajo do të marrë formë vetëm përmes një përpjekjeje të qëllimshme dhe të organizuar për të ndryshuar **kulturën** e

kishës. Në këtë artikull, do të përshkruaj një përqasje të organizuar e cila funksionon.

Kur shqyrtohet planimetria e kishës pajisëse, janë dy matje vendimtare që përcaktojnë suksesin e saj: përkushtimi i udhëheqjes për të pajisur dhe përkushtimi i shërbesës për të pajisur. Të dyja këto duhet të maten. Të dyja bashkëpunojnë për të arritur objektivin e përgjithshëm të pajisjes (ndreqjes) së shenjtoreve. Më poshtë kemi matjen e parë.

MATJA E PËRKUSHTIMIT TË UDHËHEQJES PËR TË PAJISUR

Kjo matje nuk mund të jetë hamendësim. Kjo matje e parë do të përcaktojë nëse ëndrra juaj do të mbetet një ëndërr. Të gjitha kishat bëjnë njëfarë ndreqjeje (apo pajisjeje), por jo të gjitha kishat janë kisha pajisëse. Një kishë me të vërtetë pajisëse mishëron një kulturë pajisëse. Udhëheqja e saj është e përkushtuar për të zhvilluar dhe për të mbajtur një kulturë pajisëse në mbarë kishën.

Kishat pajisëse nuk janë aksidente.

Ato janë rezultat i lutjes, planifikimit dhe praktikës së qëllimshme e të paramenduar.

Më poshtë janë disa vëzhgime rreth përkushtimit të udhëheqjes drejt një kulture pajisëse.

Ndjekja pas një kulture pajisëse do të thotë të ndjekësh ndryshimin

Kjo ndjekje (apo kërkim) do të testojë nivelin e përkushtimit të udhëheqjes. Ndryshimet që duhet të bëhen janë domethënëse, dhe ndryshimet duhet të fillojnë në nivelet më të larta. Ndryshimi është jetëdhënëse, por askush nuk duhet të supozojë që të

gjithë do ta përqafojnë ndryshimin. Njerëzit, madje edhe ata të mirët, nuk e pëlqejnë ndryshimin. Shpeshherë i dëgjojmë drejtuesit që thonë: “Unë tashmë jam i përkushtuar ndaj pajisjes”. Në rast se udhëheqja do ta mishëronte pajisjen si një **kulturë**, atëherë ata do të ishin tashmë duke e jetuar ëndrrën.

Një kulturë pajisëse fillon me portretin e duhur

Kur përfytyrojmë se si duket një kishë e suksesshme e cila e nderon Krishtin, duhet të jemi të sigurt që po shohim të njëjtën tablo që sheh edhe Perëndia. Merrni në konsideratë tablotë në vijim të kishës tek Veprat e Apostujve 2:42–47; 4:32–35.

Efesianëve 4 është tabloja më e shquar në galeri. Mund të mësojmë shumë edhe nga portretet e tjera, por Efesianëve 4 është produkti i përfunduar. Ndërsa të tjerat nuk janë të tilla. Këtu, njerëzit e Perëndisë ia kushtojnë veten e tyre planit të Tij për njerëzimin. Së bashku, ata pajisin “për veprën e shërbimit dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit, derisa të arrijmë të gjithë tek uniteti i besimit dhe i njohjes së Birit të Perëndisë, te një burrë i përsosur, në masën e moshës së plotësisë së Krishtit, që të mos jemi më foshnja, të hedhur andej-këndeje dhe të çuar aty-këtu nga çdo erë e doktrinës, nëpërmjet mashtrimit të njerëzve dhe dinakërisë së tyre që me dredhi çojnë në gabim, por, duke thënë të vërtetën me dashuri, të rritemi në çdo gjë drejt atij që është kreu, Krishti.” (Efesianëve 4:12–15).

Vini re se këtu nuk përmendet asgjë rreth një grupi adhurimi të talentuar, rreth pajisjeve të kishës, stilit të muzikës, dramës, evenimentit të madh të radhës, apo madje as rreth numrit të njerëzve që ishin të pranishëm. Këto janë të gjitha të rëndësishme në kontekstin e duhur, por ato nuk janë rezultati. Ato janë vetëm vegla për përdorim nga kisha. Dhe janë imazhe të turbullta në krahasim me portretin e gjallë të Efesianëve 4.

Efesianëve 4 është tabloja e një kishe duke përbushur Porosinë e Madhe. Në kulturën e sotme të kishës, bashkë me shpërqendrimet e saj të shumta, ne duhet t'i fiksojmë sytë tanë tek portreti i duhur.

LUTJET ME BESIM TË NJË KULTURE PAJISËSE

Këto lutje të vazhdueshme motivohen nga besimi se njerëzit do ta kuptojnë thirrjen e tyre, dhënë prej Perëndisë, dhe potencialin e tyre shpengues në Krishtin. Lutjet e tilla tregojnë që njerëzit janë burimi më i madh i kishës, dhe njerëzit e thyer kanë potencial shpengues. Këto janë vlerat e një kulture pajisëse. Lutjet e një udhëheqësi pajisës drejtohen

nga besimi që çdo person ka vlerë në planin e Perëndisë. Këta udhëheqës luten që sytë e tyre të jenë të hapur në mënyrë që të shohin dhuntitë e Perëndisë tek çdo person. Ata luten për urtësi dhe frymë dallimi për t'i pajisur dhe për t'i çliruar ato dhunti. Këto lutje nuk tregojnë besim apo siguri tek ajo që mund të arrihet duke përdorur paratë, por tek ajo që mund të përmbushë Perëndia përmes njerëzve.

PAJISJA DHE VIZIONI

Përgatitja e njerëzve për vendin e tyre të përcaktuar në planin e Perëndisë është një vlerë thelbësore për drejtuesit që i pajisin të tjerët. Ajo që shpesh keqkuptohet rreth pajisjes është marrëdhënia e saj me vizionin e kishës.

Pajisja nuk është një qëllim në vetvete dhe as plotësimi i një vizioni. Pajisja nuk e zëvendëson vizionin dhe ëndrrën për të fituar qytetet tona për Krishtin. Pajisja nuk është destinacioni, por mënyra se si udhëtojmë. Ëndrrat dhe vizionet që na ka dhënë Perëndia bëhen më të rëndësishme për një kishë pajisëse për dy arsye.

Së pari, njerëzit kanë nevojë të jenë të lidhur me një ëndërr në mënyrë që të fillojnë veprën e shërbesës. Një nga problemet e shumë kishave vendore është që nuk kanë një ëndërr mjaftueshëm të madhe në mënyrë që t'i bashkohen të tjerët. Shpesh shërbesat u kërkojnë njerëzve që një ose dy prej tyre t'u bashkohen; por, kur vijnë pesë, ata nuk e kanë idenë se çfarë të bëjnë me ta. Shpesh nuk bëjnë asgjë me ta, dhe pas gjashtë muajsh pyesin veten se ku u shkuan rekrutët e rinj.

Së dyti, kisha dhe çdo shërbesë në kishë duhet t'i përgjigjet dy pyetjeve:

1. Kush do t'i pajisë partnerët potencialë në shërbesë?
2. Si do t'i pajisim rregullisht partnerët potencialë në shërbesë gjatë gjithë vitit?

Ne lutemi për punëtorë, por shumë drejtues nuk do të dinin çfarë të bënin me ta në rast se lutja e tyre do të merrte përgjigje. Mungesa e përgatitjes ose e pajisjes është një nga arsyet që shumë partnerë potencialë të shërbesës heqin dorë përpara se të përfshihen.

Ndërkohë që bëjmë veprën e shërbesës dhe kërkojmë të arrijmë vizionin, do t'i sjellim edhe të tjerët pas vetes. Ata do të mësojnë duke vëzhguar. Eventualisht, ata do të trajnojnë njerëz të tjerë në punën që dikur e bënë ne. Pajisja nuk është një qëllim në vetvete; është një praktikë e shërbesës.

CRAIG E. SWEENEY është një nga pastorët e kishës People's Church në qytetin Fresno të Kalifornisë.

PUNA E NJË KULTURE PAJISËSE

Një kulturë pajisëse përqendrohet tek puna efikase në skuadër. Ajo nuk shqetësohet kryesisht rreth prodhimit të një anëtar të stafit. Anëtarët e stafit nuk janë marrë në punë për të qenë bërës profesionistë të shërbesës. Ata duhet të merren në punë për të krijuar dhe për të trajnuar skuadra me partnerë nga radhët e besimtarëve të thjeshtë të cilët në vijim do të përmbushin përpjekjet e shërbesës. Në këtë kulturë, anëtarët e stafit nuk lavdërohen kur bëjnë punën e pesë njerëzve ndërkohë që sforcojnë marrëdhëniet e tyre familjare. Ata lëvdohen që sigurohen se pesë individë bëjnë punën e pesë vetëve.

Në këtë kulturë,
anëtarët e stafit nuk lavdërohen kur bëjnë punën e pesë njerëzve
ndërkohë që sforcojnë **marrëdhëniet e tyre familjare.**

Një person i cili nuk punon aty ku janë dhuntitë dhe pasioni i tij, do të rraskapitet dhe do të zërë vend midis cinikëve të bashkësisë. Ne duhet të shmangim procese që krijojnë cinikë. Një kulturë pajisëse nuk dëshiron që kushdo të punojë kudo; por dëshiron që njerëzit e duhur të punojnë në vendet e duhura në momentet e duhura.

Strategjitë e një kulture pajisëse

Strategjitë nuk janë aq të interesuara për shifrat, sa janë për cilësinë. Bërja e dishepuje ndodh në kohën e vet, person pas personi. Mjedisi i grupit të madh luan një rol në këto strategji, por në një pikë të caktuar është i nevojshëm trajnimi veç e veç. Evenimentet e mëdha dhe të kushtueshme zakonisht tërheqin njerëz që shkojnë tashmë në kishë, por një strategji më e mirë është që t'ua çojmë mesazhin e shpresës të humburve. Shumë kisha planifikojnë ngjarje për të futur më shumë njerëz brenda ambienteve të tyre në mënyrë që t'u flasin. Një kishë pajisëse përdor kohën dhe burimet e saj për të pajisur njerëzit në mënyrë që ata t'u shërbejnë njerëzve në ato vende që pastori nuk mund t'i arrijë.

Objektivat dhe prioritetet e një kulture pajisëse

Është e nevojshme të kemi objektiva afatgjatë për pajisjen të cilët shtrihen nga 1 vit deri në 5 vjet. Shembuj të objektivave afatgjatë janë: ngritja e drejtuesve të rinj nga radhët e besimtarëve për të bërë atë që ka bërë stafi i cili paguhet (ky objektivi do ta lirojë stafin e paguar për të bërë gjërat që i pëlqen të bëjë); zhvillimi i marrëdhënieve mentoruese; zhvillimi i kurrikulave të reja për të ndihmuar me

përpjekjet për të pajisur; menaxhimi i drejtuesve nga radhët e besimtarëve dhe i pritshmërive të tyre për të pajisur drejtues të tjerë nga radhët e besimtarëve të thjeshtë. Objektivat dhe prioritetet duhet të reflektojnë kulturën pajisëse.

Indikatorët e një kulture pajisëse për të matur suksesin

Shpesh indikatorët që përdoren sot për të matur suksesin janë imazhe të mjegullta të Efesianëve 4. Pjesëmarrja e madhe dhe financat e mira nuk e tregojnë të gjithë historinë. Xhorxh Barna (George Barna) në librin ***Growing True Disciples*** (Të rrisësh dishepuj të vërtetë) shkruan: "Aktualisht, më pak se gjysma e të gjithë të rriturve të rilindur (44 për qind) janë të bindur që ekziston e vërteta morale absolute".

Pesëdhjetë e gjashtë për qind e tyre nuk janë të bindur. Vetëm "55 për qind pohojnë se ndikimi parësor për mendimin që kanë rreth të vërtetës morale është Bibla ose edukimi fetar që marrin". Këta janë njerëz që vijnë në kishat tona. Shifrat nuk na thonë atë që ne duam të dëgjojmë. Një kulturë pajisëse afrohet shumë me njerëzit e saj dhe i angazhon ata në besimin e tyre. Ka ikur koha e supozimit se të gjithë bien dakord me predikimin apo mësimin tonë.

Nevojiten indikatorë të rinj të suksesit. Suksesi mund të përcaktohet duke parë se kush është i angazhuar në procesin e dishepullizimit; sa njerëz japin të dhjetën; sa njerëz janë të përfshirë në shërbesat që janë në vazhdim; sa njerëz janë të përfshirë në marrëdhënie përmes grupeve të vogla ose klasave të shkollës së të dielës; sa familje të prishura janë shpëtuar nga divorci; dhe sa njerëz janë duke u nisur drejt shërbesave të reja. Këta indikatorë nuk janë të përsosur, por ata japin një vlerësim të mirë nëse një person po kthehet ose jo në një dishepull të Jezu Krishtit.

Një kulturë pajisëse promovon me largpamësi

Udhëheqësve nëpër kishat pajisëse iu jepet më shumë përgjegjësi nëse dhuntitë e tyre i kualifikojnë për këto përgjegjësi. Promovimi kërkon maturi (largpamësi). Shumë kisha kanë më tepër lojtarë seç duhet në stafet e tyre të trajnimit. Trajnerët dhe lojtarët përdorin aftësi të ndryshme; të ngjashme, por të ndryshme. Pozicionet me përgjegjësi të lartë, në mënyrë tipike, kërkojnë aftësi më të mëdha pajisëse.

Por, personat që e bëjnë mirë detyrën nuk janë automatikisht trajnerë të mirë. Majkëll Xhordan është ndoshta basketbollisti më i mirë i të gjitha kohërave; por, në rast se ai nuk mund ta trajtojë ose pajisë një lojtar për të luajtur si ai, atëherë do të ishte shumë pak i dobishëm si trajner për skuadrën. Nuk do të ishte e drejtë, as për të, as për skuadrën, që ne ta bënim Xhordanin një trajner. I promovoni njerëzit sipas dhuntive të tyre.

Një kulturë pajisëse krijon një trashëgimi

Trashëgimia e një pastori mbetet kur ai lëviz nga një vend në tjetrin ose kur ngrihet në pozitë për të qenë me Krishtin. Ne duhet të pyesim: ***“A do ta vazhdojnë të tjerët atë që kam filluar unë dhe ta çojnë atë më tej edhe pasi të jem larguar?”*** ose ***“A është ky aktivitet i tillë që duhet të vazhdohet edhe pasi jam larguar unë?”***

Në qoftë se një kulturë pajisëse është e themeluar, atëherë vizioni dhe pasioni i pastorit do të bëhen gjithashtu vizioni edhe pasioni i të tjerëve. Pajisja e njerëzve të tjerë për t’iu bashkuar përpjekjeve tona garanton se ëndrra që kemi, nuk vdes. Trashëgimia më e madhe që ne si udhëheqës pajisës lëmë pas, nuk është e shkruar nëpër pllakate të fiksuara brenda mureve të një ndërtese. Trashëgimia më e madhe që lëmë pas është e shkruar mbi zemrat e njerëzve që kemi ndihmuar. Për çdo herë që një person i ri i bashkohet Perëndisë në planin e Tij për shpengimin e njerëzimit, trashëgimia jonë vazhdon të jetojë dhe frytë ynë mbetet.



Imagjinoni sikur që të gjithë nga stafi dhe nga drejtuesit nga radhët e besimtarëve të përkushtoheshin ndaj një kulture pajisëse. Ky është hapi i parë për t’u bërë një kishë pajisëse. Hapi tjetër është t’u hidhni një shikim me ndershmëri shërbesave në kishën tuaj.

Me garantimin e përkushtimit të udhëheqjes, hapi i radhës në planimetrinë e kishës pajisëse është që shërbesat e kishës të reflektojnë kulturën pajisëse. Çdo shërbesë apo departament duhet të shqyrtohet për të përcaktuar nëse është efikase për ndreqje (pajisje). Departamentet efikase pajisin qëllimisht njerëz, ndërkohë që bëhet shërbesa.

Nuk është e thënë që të gjitha shërbesat të jenë shërbesa efikase e pajisëse. Shumica e shërbesave as nuk janë hapur, e as nuk janë mirëmbajtur, si shërbesa pajisëse. Shumë prej tyre erdhën në jetë nga një dëshirë për të plotësuar një nevojë. Për shembull, burrat e kishës kanë nevojë për ndihmë që të bëhen burrat që Perëndia i thirri të ishin, dhe kështu fillohet një shërbesë burrash. Pajisja mund të ndodhë me doza të vogla, por mund të bëhet edhe më shumë.

Çdo shërbesë ka nevojë për lejen e udhëheqjes kryesore për të matur përkushtimin e saj të tanishëm ndaj pajisjes. Shkolla e së dielës është një shërbesë pajisëse. Në të vërtetë, shërbesa pajis vetëm atëherë kur objektivi i saj është bërja e dishepujve. Shumë prej shkollave të së dielës nuk pajisin me efikasitet. Ato i kanë lënë në “pilot automatik”. Ato përdorin librin ose diskun aktual me seri dhe japin mësim duke menduar pak ose aspak rreth rezultateve. Kur përfundon një seri, fëmijët emocionohen për serinë e ardhshme edhe pse studimet që sapo janë mësuar nuk janë përfshirë në jetët e njerëzve. Individët kanë aftësinë unike për të dëgjuar mësimdhënie për javë me radhë dhe ende të mbeten të pandryshuar.

Përkushtimi i shkollës së të dielës për të pajisur, mund të matet. Mund të matet përmes vendimit të saj për të qenë e qëllimshme me mësimet e veta. Klasat duhet të fillohen duke pasur në mendje një objektiv të rritjes. Për shembull, rritje në kujdestarinë financiare, në kuptimin e rolit të bashkëshortit, bashkëshortes dhe fëmijëve në një familje, ose në kuptimin e mënyrave se si dikush mund t’i përdorë vitet e pensionit në avantazh të mbretërisë së Perëndisë. Pasi shumica ose të paktën mësuesit e shkollës së të dielës kanë rënë dakord për një objektiv të rritjes, përdoren materiale që do t’i nxisin njerëzit në atë drejtim.

Më pas ata mund të ndahen në grupe të vogla për t’u lutur për forcën e Perëndisë në mënyrë që t’i përgjigjen saktë mësimëve të asaj jave. Me kalimin e kohës, formohen marrëdhënie që ofrojnë llogari-

SHTATË HAPA PËR TË PASUR VULLNETARËT E DOMOSDOSHËM

A jeni të lodhur duke u përpjekur të fusni kunja katrore në vrima rrethore? A vazhdojnë t'ju mbarojnë kunjat e çdo forme qofshin ato? Në rast se jeni përgjegjës për rekrutimin e vullnetarëve për kishën tuaj, atëherë e dini se sa acaruese mund të jetë gjetja e njerëzve të duhur për të gjitha pozicionet. Zgjidhje për këtë nuk janë teknikat më të mira të rekrutimit, por një perspektivë e freskët rreth asaj që po përpiqeni të arrini.

Siç tha edhe futuristi Leonard Sweet: “Kisha e Jezusit nuk ka vullnetarë, por ka shërbetarë”. Mos e shihni punën tuaj si çështje e mbushjes së të gjitha vrimave, por si një shërbesë që nis dhe pajis njerëz për të ushtruar dhuntitë e tyre frymërore. Më poshtë keni disa mënyra praktike për t'iu përqasur asaj.

LUTUNI

Ndonjëherë ne harrojmë që kisha nuk është thjesht një sipërmarje njerëzore. Lutja duhet të jetë prioriteti ynë i parë, dhe jo shpresa e fundit. Kur Jezusi u përball me një situatë ku shërbesa kishte më pak staf seç duhej, Ai nuk i dërgoi dishepujt e tij që të bënin presion apo të detyronin të tjerët. Por ai u tha atyre: “Lutjuni, pra, Zotit të të korrave, që të dërgojë punëtorë” (Mateu 9:38). Lutja duhet t'i paraprijë dhe t'i përshkojë tërësisht secilin prej hapave të tjerë të vepimit.

IDENTIFIKONI DETYRAT

Shkruani të gjitha funksionet që keni nevojë të kryhen nga vullnetarët. Në qoftë se rekrutimi i individëve që kanë dhunti do të ishte thjesht çështje pyetjeje, çfarë lloj vullnetarësh do të donit? Një mësues tërheqës të Biblës? Një person që i bie tastierës i cili mund t'i shkëmbejë refrenet aty për aty?

Ndërkohë që i bëni këto, hartoni strukturën e të gjithë shërbesës, duke treguar secilin departament dhe vendin ku shërben secili vullnetar. Mund të zbuloni që mund të lehtësoni një mangësi në një fushë, thjesht duke iu ricaktuar vendet disa prej njerëzve që janë tashmë duke shërbyer.

SPECIFIKONI AFTËSITË

Mendoni me kujdes se çfarë dhuntish dhe aftësish duhet të ketë secili nga vullnetarët. Xhim Uajdmen (Jim Wideman) në faqen e internetit Church on the Move in Tulsa, Oklahoma (Kisha në lëvizje në Tulsa, Oklahoma), zbulon që shumë drejtues shërbesash nuk janë të sigurt se çfarë duhet bërë saktësisht dhe për sa kohë, nëse burimet e nevojshme janë në dispozicion ose jo dhe si ta përllogarisin efikasitetin. Ai thotë: “Asgjë nuk i tremb dhe nuk i largon më shpejt vullnetarët sesa kur nuk jeni të qartë rreth asaj që keni nevojë”.

SHKRUANI PËRSHKRIME PUNE

Tani merrni ato që keni menduar dhe përpiloni një përshkrim pune të shkruar për secilin pozicion. Kjo duhet të jetë diçka të cilën mund t'ia dorëzoni vullnetarëve potencialë në mënyrë që ata ta dinë me saktësi se për çfarë po flisni dhe të mund të marrin një vendim të mençur. Kjo gjithashtu ju ruan juve nga rënia në kurthin e përpilimit të përshkrimit të punës që i përshtatet një personi të caktuar në vend që t'i përshtatet detyrës. Pasi ta keni përshkruar detyrën, mund të kërkontë personin e duhur që do t'ju ndihmojë të risë

shërbesën. Uajdmen thotë: “Më mirë të mos kem fare vullnetarë sesa të kem vullnetarët e gabuar”.

VLERËSONI DHE PAJISNI VULLNETARËT AKTUALË

Personi për të cilin keni nevojë mund të jetë tashmë në skuadrën tuaj. Ndoshta ju thjesht duhet të mprihni aftësitë e tij ose ta trajtoni paksa për ta çuar atë në nivelin tjetër. Vlerësoni performancën e vullnetarëve tuaj; kjo i bën ata të kuptojnë se ju keni pritshmëri të larta dhe jep mesazhin se ajo që ata po bëjnë është e rëndësishme. Kërkoni që të vlerësojnë vetveten, duke iu treguar për tri fusha në të cilat dëshirojnë të përmirësohen. Pastaj, ndihmoni që t'i mprehin ato aftësi duke iu mësuar atyre parimet themelore dhe duke modeluar zakonet e mira.

LEJOJINI VULLNETARËT TUAJ QË TË REKRUTOJNË

Ata që janë tashmë duke shërbyer në një shërbesë mund t'i rekrutojnë të tjerët më lehtësisht sesa ju. Njerëzit presin që, si rekrutues, ju t'i paraqisni mundësitë për vullnetarë në një mënyrë të favorshme, por ata i besojnë dikujt që është në llogore për ta thënë të vërtetën siç është. Inkurajojini punëtorët tuaj më të mirë për të folur me bashkëmoshatarët e tyre për t'iu bashkuar skuadrës. Përgjegjësia e shoshitjes dhe e trajnimit mbetet përsëri e juaja, por nuk ju duhet të jeni personi që gjen të gjithë vullnetarët e rinj.

PYESNI KËDO NË ÇDO KOHË

Një nga arsyet që nuk kemi mjaftueshëm vullnetarë është fakti që dështojmë t'u përqasemi individëve. Në një anketë të anëtarëve të kishës në SHBA, Xhorxh Gallup (George Gallup) zbuloi se vetëm 10 për qind ishin aktivë në një shërbesë vetjake, ndërkohë që 40 për qind e tyre shprehën interesin për të qenë të përfshirë në ndonjë shërbesë. Arsyeja përse nuk ishin të përfshirë, ishte sepse askush nuk ua kishte kërkuar ose nuk e dinin se si të përfshiheshin.

Mos prisni derisa të vijë e diela e promovimeve apo derisa dikush të japë dorëheqjen. Jini gjatë gjithë kohës në kërkim për njerëz të mirë. Në rast se takoni një person i cili duket i kualifikuar, nxirri jashtë përshkrimet e punës dhe shikoni nëse përputhet me një prej tyre. Në qoftë se po, atëherë përfshijeni menjëherë atë person.

Uajdmen sugjeron që të bëni një listë me të gjithë anëtarët e kishës suaj të cilët nuk janë duke shërbyer në asnjë cilësi. Më pas, kontaktojini një nga një dhe i ftoni të marrin në konsideratë përfshirjen në një shërbesë të caktuar. “Ka njerëz në bashkësinë tuaj që kanë nevojë të jenë të nevojshëm”, thotë ai. “Gjejini ata. Kur të lidheni me këta persona, ata do të jenë punëtorët më besnikë që keni parë ndonjëherë”.

DENNIS CONE. © E drejta e autorit 2005. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. E përdorur me autorizim nga Pastors.com. Adaptuar nga kapitulli 12, Children's Ministry Leadership: The You-Can-Do-It Guide, me autor Jim Wideman, botuar nga Group Publishing, P.O. Box 481, Loveland, CO 80539, <http://www.group.com>

dhënie dhe që e nxisin njëri-tjetrin për të vazhduar. Pajisja i motivon njerëzit që t'i vënë në zbatim dhe t'i përvetësojnë ato që u janë mësuar. Pajisja mund të ndodhë në doza të vogla gjatë shkollës së të dielës, por shkolla e së dielës mund të jetë më e qëllimshme në bërjen e dishepujve.

Çdo shërbesë e kishës duhet të matet. Pasi të matet, udhëheqja mund ta rishqyrtojë qëllimin e shërbesës për t'i pajisur njerëzit. Për shembull, qëllimi i shërbesës së vizitave në spital është për t'u bërë vizitë të sëmurëve dhe njerëzve në nevojë që janë në spital, por kjo shërbesë gjithashtu mund edhe të pajisë të tjerët. Në qoftë se drejtuesi aktual do të marrë persona të tjerë me vete dhe do t'u tregojë se si bëhen vizitat në spital, atëherë dy njerëz janë tashmë të trajnuar si t'i bëjnë këto vizita. Po të mos e krijojë paria këtë pritshmëri, atëherë shumë shërbesa nuk do t'i pajisin të tjerët automatikisht për të shërbyer. Kjo është një arsye se përse udhëheqësit duhet të përkushtohet të parët ndaj pajisjes. Xhon Maksuell (John Maxwell) thotë: "Gjithçka ngrihet e bie mbi udhëheqjen".

Pika e fundit për t'u marrë në konsideratë është një plan dishepullizimi. Cila do të ishte sasia **minimale** e informacionit që iu nevojitet njerëzve për të qenë ndjekës emocionalë të Jezu Krishtit? Cilat janë doktrinat, praktikat apo disiplinat bazë që iu nevojiten të gjithëve? Hapi i parë në zhvillimin e një plani dishepullizues është përgjigjja e këtyre pyetjeve. Kisha duhet të ofrojë një sërë orësh mësimi dhe mundësi mentorimi veç e veç ku njerëzit mund ta marrin atë informacion. Të shpresojmë që kisha frekuentohet rregullisht nga njerëz që vijnë për herë të parë. Mundësitë e reja për dishepullizim duhet të jenë në dispozicion për këta individë gjatë gjithë vitit.

Plani ynë fillon me ata që veprojnë nga altari. Ata janë të trajnuar për t'i inkurajuar njerëzit që ta çojnë më tej përkushtimin e tyre duke iu bashkuar një ore mësimi ose një marrëdhënieje mentoruese. Orët e mësimi dhe mentorët mësojnë doktrinat dhe disiplinat themelore. Pas përfundimit, njerëzit janë të inkurajuar që t'i bashkohen një grupi të vogël dhe orës tjetër të mësimi sipas planit për besimtarin e ri.

Ne kemi të paktën gjashtë orë mësimi, të cilat përbëjnë procesin e dishepullizimit. Kjo është një mënyrë efikase për t'i familjarizuar personat të cilët vijnë për herë të parë, me komunitetin e kishës. Proceset e dishepullizimit do të jenë ndryshe për secilën kishë. Qëllimi është që të çlirojnë për në shërbesë ata njerëz që janë të mirë-pajisur dhe të kualifikuar për të shërbyer. Përmbylleni procesin e dishepullizimit me një orë të shkurtër mësimi për të vlerësuar dhuntitë frymërore të pjesëmarrësve. Në

vijim të orës së mësimi jepuni njerëzve një mundësi për të parë shërbesat e disponueshme për t'u zgjedhur në kishën tuaj.

Kishat pajisëse nuk janë aksidente. Ato janë rezultat i lutjes, planifikimit dhe praktikës së qëllimshme e të paramenduar. Ëndrra mund të marrë formë vetëm kur miratohet një qëndrim i qëllimshëm dhe i organizuar për të ndryshuar kulturën e kishës. Pajisja nuk ndodh vetvetiu në kishë. Kishat duhet të kalojnë përmes një procesi planifikimi, ku udhëheqjes i është dhënë përfundimisht autorizimi për të punuar si drejtues që pajisin. Duhet t'i kushtojmë kohë dhe burime trajnimit të bashkësisë dhe ritrajnimit të drejtuesve. Koha e përdorur nga kisha dhe pritshmëritë e pastorëve dhe të drejtuesve nga radhët e besimtarëve janë ndryshe kur pajisja është e qëllimshme.

Shumë drejtues mund të mendojnë se ky ndryshim i kulturës tingëllon paksa i pamasë dhe madje edhe i frikshëm. Unë besoj se ai është i mbushur me mundësi dhe shanse.


**Çfarë do të arrihej
nëse vetëm gjysma e njerëzve në kishë
do ta dinin vendin
e tyre në planin e Perëndisë, do të ishin
të pajisur, dhe pastaj
të çliruar për të marrë
pjesë në atë plan?**

Kjo lloj kishe është gjallëruese, energjike, e fokusuar tek marrëdhëniet dhe e bekuar me miratimin e Perëndisë. Mua më pëlqen të jem një drejtues në këtë lloj kishe. Kjo padyshim që nuk është kisha e zakonshme, por kjo është një gjë e mirë.



CRAIG E. SWEENEY,

është një nga pastorët në Kishën e Njerëzve (People's Church) në qytetin Fresno të Kalifornisë.



PROCESI I PAJISJES NË KISHËN MË TË VOGËL

Nga: **DON R. SIMMONS**

Është e rëndësishme që çdo person në një bashkësi me madhësi, staf dhe burime të pakta, të pajiset. Atëherë, si e pajis një pastor çdo person në një bashkësi të vogël?

Shumë udhëheqës besojnë se nuk mundën që të zhvillojnë një sistem pajisës në kishën e tyre për shkak se kisha e tyre është tepër e vogël dhe nuk mund ta përballojë financiarisht një drejtor pajisës ose një sistem kompjuterik për menaxhimin e anëtarëve. Këto supozime janë të pasakta kur dikush shqyrton mënyrën si ta zhvendosim një kishë, pavarësisht madhësisë së saj, nga mirëmbajtja drejt shërbesës.

Si mund të kthehet një kishë e vogël në një kishë pajisëse? Së pari, një kishë pajisëse ka nevojë për mbështetje të dukshme nga pastori kryesor dhe nga udhëheqja kryesore e kishës. Pastori duhet të bëjë më shumë sesa thjesht të urojë që kisha të fillojë pajisjen. Pastorët dhe drejtuesit duhet të mësojnë si të pajisin dhe si t'i çlirojnë të tjerët për në shërbesë. Më shpesh seç duhet, pastorët e kishave të vogla përpiqen të jenë omnikompetentë (të aftë në gjithçka) dhe të bëhen mikromenaxherë. Nga foltorja e

deri tek rregullimi i tualeteve, pritet që pastori t'i bëjë të gjitha, dhe t'i bëjë mirë madje. Por kjo nuk është ajo për të cilën pastorët janë thirrur që të bëjnë.

Roli biblik i pastorëve është që t'i pajisë të tjerët për shërbim. Ideja e pajisjes është që të çlirohen dhe të lejohen njerëz, pra, anëtarë të papaguar dhe të pashuguruar të kishës, për të bërë detyra shërbyese. Shumë pastorë të kishave të vogla supozojnë se duke qenë se bashkësia është e vogël, atëherë ata duhet t'i bëjnë të gjitha. Por është pikërisht kjo mendësi ajo që i mban kishat të vogla. Pastorët mund të kapen kaq fort pas udhëheqjes, sa që shërbesa nuk ka mundësi që të shumëfishohet dhe të zgjerohet.

Zgjerimi i shërbesës qeveriset nga kapaciteti i pastorit për t'i nxjerrë (apo për t'i çliruar) të tjerët në shërbesë. Shumë prej pastorëve besojnë që njerëzit e tyre nuk mund të shërbejnë po aq mirë sa ata. Por kush është përgjegjës për t'i pajisur ata? Kush është përgjegjës për të ofruar mundësi për të mësuar? Përse duhet të supozojë pastori se ai është i vetmi që është në gjendje të dëgjojë nga Perëndia dhe i vetmi i pajisur me dhunti për të shërbyer?

Së dyti, një kishë pajisëse ka nevojë për një person kyç, i cili të punojë me një skuadër për të përkrahur shërbesën pajisëse në kishën e vogël. Skuadra e kishës së vogël mund të jetë e paktë në numër, por një person kyç i talentuar dhe i mbushur me pasion (i cili shpesh është i papaguar) mund të sjellë në jetë dhe të zhvillojë shërbesa pajisëse.

Shërbesat pajisëse mund të përfshijnë shumë anëtarë të papërfshirë e të mënjanuar, madje edhe disa persona të cilët ende nuk janë bërë pjesë e kishës. Personi kyç ka përgjegjësinë dhe autoritetin për ta drejtuar skuadrën që të adresojë gjendjen ekzistuese të udhëheqjes së kishës. Personat kyçë mund të ngrenë sisteme për të ftuar njerëz të rinj; të asimilojnë personat që vijnë për vizitë dhe anëtarët;

të krijojnë një proces të zbulimit, përshtatjes dhe vendosjes së dhuntive, duke i ftuar njerëzit për në shërbesë; dhe të trajtojnë dhe të dallojnë drejtues shërbesash. I gjithë procesi është pronë e tyre dhe ata e prodhojnë atë në çdo shërbesë.

Së treti, një kishë pajisëse ka nevojë për një sistem të plotë pajisës. Kjo është veçanërisht e vërtetë në kishën më të vogël në numër. Një sistem i paplotë i pengon disa anëtarë që të arrijnë një dishepullizim të pjekur. Për shembull, shumë kisha të vogla zhvillojnë një proces të mirë për zbulimin e dhuntive, megjithatë kjo vetëm sa u jep njerëzve një njohuri të dhuntive të tyre, por shumë pak informacion se si, kur dhe ku përdoren më së miri dhuntitë e tyre në kishë. Pasi një anëtar është vendosur në një vend të caktuar, atij i duhet ofruar trajnimi, konfirmimi, reagimi, vlerësimi ose njohja për shërbimin e tij. Përndryshe, kjo mund të jetë acaruese dhe anëtarët mund të japin dorëheqjen nga pozicionet e shërbesës duke u ndjerë të zhgënjyer.

Kisha e vogël ka një mundësi unike për të ndërtuar skuadra të forta për shkak të marrëdhënieve të ngushta që mund të formohen në grupe të vogla. Udhëheqësit mund të zhvillojnë skuadra shërbesë pa ndërtuar marrëdhënie të reja, gjë e cila mund të jetë e nevojshme në kishat më të mëdha.

Kisha e vogël ka një avantazh të madh. Një kishë e vogël mund t'i adoptojë më shpejt praktikën dhe proceset e reja për shkak se nuk i ka strukturat e personelit dhe të menaxhimit që ndonjëherë i pengojnë kishat më të mëdha. Është e vërtetë që një barkë e vogël mund ta marrë më shpejt kthesën se sa *Titaniku*.

Kisha e vogël shpesh pozicionohet për të zhvilluar shërbesa të specializuara përmes pajisjes, gjë për të cilën kishave më të mëdha, do t'u duheshin vite, takime të panumërta dhe shumë para për t'i përmbushur. Në vitet 90, kur tërmetet dhe zjarret shkatërruan lagje të tëra në Kaliforninë jugore, bashkësitë më të vogla u përgjigjën më shpejt për shkak të rrjetit të tyre të thjeshtë të komunikimit dhe njohurisë së brendshme të dhuntive dhe pasioneve që kishin në dispozicion. Kishat më të mëdha nuk mund të reagojnë kaq shpejt. Megjithatë kisha më e madhe mund të jetë në gjendje që të sigurojë burime më të shumta financiare, kishat e vogla, meqë punojnë së bashku, sigurojnë një ushtri me shërbëtorë të përkushtuar.

Kisha e vogël ka një mundësi unike për të ndërtuar skuadra të forta për shkak të marrëdhënieve të ngushta që mund të formohen në grupe të vogla

Për shkak se urdhërimi për të ndrequr (apo pajisur) shenjtorët tek Efesianëve 4:11-12 nuk ka mbiemra cilësues, siç janë madhësia, stafi, zona rurale apo urbane, të varfër apo të pasur, si dhe për sa i përket anës etnike, atëherë pajisja është e zbatueshme për çdo kishë.

Burimet

Mallory, Sue. 2001. *The Equipping Church*. Grand Rapids: Zondervan.

Mallory, Sue, Brad Smith, Neil Wilson, dhe Sarah Jane Rehnberg. 2001. *The Equipping Church Guidebook*. Grand Rapids: Zondervan.

Ogden, Greg. 2003. *Transforming Discipleship: Making Disciples a Few at a Time*. Downers Grove, Ill.: InterVarsity Press.

Swanson, Eric. 2004. *The Externally Focused Church*. Loveland, Colo.: Group Publishing.



DON R. SIMMONS, Ph.D.,
është drejtor i Pajisjes dhe i
Zhvillimit të Udhëheqjes, në
Fresno, Kaliforni.

DISHEPULLIZIMI NË NIVELIN MASTER

Nga: MARCIA LEDNICKY

Bashkë me shumë ndjekës të tjerë të devotshëm, Jezusi kishte dymbëdhjetë dishepuj të afërt. Ata ishin burra të cilët Ai i kishte zgjedhur personalisht për të qenë me Të. (Ishte e qartë që Jezusi nuk i përzgjedhi ata për shkak të asaj se çfarë ata ishin në atë moment, por përkundrazi, për shkak të njohurisë që Ai kishte se çfarë do të bëheshin ndërsa do ta ndiqnin Atë). Periudha e tyre specifike e trajnimit ishte pothuajse tre vjet përgjatë shërbesës së Tij tokësore, kryqëzimit, ringjalljes dhe përfundimisht ngjitjes së Tij në qiell.

Përveç kësaj, Pjetri, Jakobi dhe Gjoni u përzgjedhën nga ky grup prej dymbëdhjetë vetësh për një nivel më intensiv trajnimi. Shpeshherë studiuesit e kanë quajtur këtë grup, *Rrethi i Brendshëm*. Vetëm ata kanë qenë me Të gjatë:

- Ringjalljes prej së vdekurish të vajzës së Jairit, *Marku 5*
- Në Malin e Shpërfytyrimit, *Marku 9*
- Ndërsa lutej në kopshtin e Gjetsemanisë, *Marku 14*

Mbani mend se të tre këta burra ishin peshkatarë. Ata ishin thjesht njerëz të zakonshëm, jo studiues të Ligjit dhe të Profetëve. Madje as nuk ishin udhëheqës—qës të mirënjohur në komunitetin fetar hebraik. Kualifikimi që ata kishin, ishte një gatishmëri për t'iu përkushtuar Jezusit. Mund të ketë raste kur ne i lutemi Perëndisë që të ngrejë udhëheqës për të ndihmuar me përgjegjësitë e shumta që janë në kishë, e megjithatë, duket sikur të gjitha gratë që janë rreth e qark nesh nuk janë të talentuara me aftësi të jashtëzakonshme udhëheqësie. *Mirëpo Perëndia!* Perëndia mundet (dhe ia arrin) që të marrë “të zakonshmet”, gra të zakonshme siç jemi ne, dhe t'i zhvillojë ato në udhëheqëse frymërore të jashtëzakonshme. Po, është e vërtetë. Ndërkohë që Perëndia na përdor për të investuar në jetët e të tjerave, me shumë mundësi, që ne mund të jemi “duke rritur” udhëheqëse dinamike. Sa emocionuese është kjo!!!

Le të shohim disa vite përpara dhe të ndjekim shërbesën e këtyre tre burrave mbasi Jezusi ishte ngjitur përsëri në të djathtë të Atit qiellor.

❖ **PJETRI** ishte ai që iu drejtua turmës së madhe që ishte mbledhur Ditën e Rrëshajëve dhe u shpjegoi atyre atë që po ndodhte në dhomën e sipërme, ndërkohë që të 120-ët filluan të flisnin në gjuhë të tjera (Veprat e Apostujve 2). Unë jam mjaft e sigurt që Pjetri nuk e pa kurrë veten si dikush i cili do të fuqizohej përmes vajosjes së mbinatyrshme për të folur përpara një grupi kaq të madh njerëzish. Megjithatë, ai kishte qenë “i dishepullizuar” ose “i mentoruar” nga Jezusi. Tani, unë e kuptoj që asnjëra prej nesh nuk mund të krahasohet me Jezusin, por Ai na përdor për të ndikuar, inkurajuar dhe trajnuar të tjerat për t'i shërbyer Atij. Si një grua në shërbesë, Perëndia ju ka dhënë juve një mundësi unike e të mrekullueshme për të investuar në të ardhmen e Kishës së Zotit tonë.

❖ **PJETRI** i foli burrit të çalë tek porta e tempullit, e kapi prej dore dhe i tha: “*në emër të Jezu Krishtit Nazarenas, ngrihu dhe ec!*”. Dhe burri u shërua

menjëherë (Veprat e Apostujve 3). Besimi ishte rrënjësor në zemrat e tyre për të besuar në fuqinë e Perëndisë ndërkohë që ata kishin vëzhguar në shumë raste fuqinë e Tij shëruese.

❖ **PJETRI** shkoi në shtëpinë e Kornelit, ushtarit romak, duke ua çuar ungjillin johebrenjve (Veprat 10). Ky ishte një largim shumë i rëndësishëm nga elita shumë paragjyktuese hebraike. Ai pa në zemrën e Jezusit dhembshurinë për të gjithë.

❖ **JAKOBI** u bë udhëheqësi i kishës së sapolindur të Dhjatës së Re në Jerusalem dhe drejtoi Këshillin e Jerusalemit, i cili kërkoi të bashkonte hebrenjtë fetarë dhe johebrenjtë paganë (Veprat e Apostujve 15).

❖ **JAKOBI** ishte Apostulli i parë që u martirizua për shkak të besimit të tij (Veprat e Apostujve 12). Një këngë e vogël, të cilën e kam kënduar shumë herë, duket e përshtatshme për këtë çast. Fjalët e saj thonë: “Unë kam vendosur ta ndjek Jezusin, unë kam vendosur ta ndjek Jezusin, unë kam vendosur ta ndjek Jezusin, unë mbrapa s'do të kthehem më”. Jam shumë e sigurt që nuk jam pesimiste, por ama besoj se jetojmë në një kohë kur disave prej nesh mund të na duhet të zgjedhim mes mohimit të Jezusit ose përballjes me vdekjen. Ndërsa investojmë tek të tjerët, qoftë me fjalë dhe me vepra, komunikojmë me zë të lartë që “asgjë tjetër nuk është më e rëndësishme sesa një përkushtim për t'i shërbyer Jezusit dhe për të ndarë mesazhin e Tij me një botë të humbur”.

❖ **GJONI** shkroi pesë libra të Dhjatës së Re, përfshirë këtu edhe librin profetik të Zbulesës, shumica e së cilës përmban të vërteta të frymëzuara që ende nuk janë përmbushur.

❖ **GJONI** u udhëzua nga Jezusi (ndërkohë që Ai ishte mbi kryq) që të kujdesej për Marinë, nënën e Tij. Pikërisht në atë moment, Jezusi, me dhimbjet e një vuajtjeje të tillë të tmerrshme, ishte i shqetësuar për nënën e Tij. Shpëtimtari ishte mbi kryq duke shprehur formën përfundimtare të dashurisë së Tij për ne. Çfarë na mëson kjo rreth dashurisë sonë për të tjerët? Mbani mend fjalët e Tij në kryq: “*Atë, fali ata sepse nuk dinë ç'bëjnë*” (Luka 23:34). Është e habitshme që Ai po tregonte dashuri pikërisht për ata që po e kryqëzonin Atë. Ne e zbulojmë me dëshirë, atë që kemi me të vërtetë në zemër, tek personat që janë shumë pranë nesh. A na shohin gratë që mentorojmë si

një person që dëshiron të “jetë baras” edhe atëherë kur dikush na ka lënduar? A po vëzhgojnë ato një frymë mosfalëse e të hidhur? Pjesa e Shkrimit që edhe më sfidon, edhe më inkurajon të jetoj një jetë me falje është Mateu 6:14-15: “Sepse në qoftë se ju ua falni njerëzve gabimet e tyre, Ati juaj qiellor do t’juua falë edhe juve; por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj nuk do t’juua falë juve gabimet tuaja”. Ndoshta cilësia më e rëndësishme që duhet të ilustrimet me shembuj përmes nesh, ndërsa jemi duke mentoruar të tjerat, është që të shprehim vazhdimisht një dashuri të madhe dhe të sinqertë për të gjithë.

❖ **GJONI** u ul në krahë të Jezusit gjatë Darkës së Fundit (Gjoni 13:23). Nuk i vendosi Jezusi vendet në tavolinë për darkën. Ishte Gjoni ai që zgjodhi të ishte sa më pranë Jezusit që të mundej.

❖ **GJONI** ishte i vetmi Apostull që pati një vdekje të natyrshme, edhe pse ishte dëbuar për në burgun e ishullit Patmos. Pikërisht aty ai shkroi Librin e Zbulesës, ndërkohë që ishte “në Frymë ditën e Zotit”. Tradicionalisht, Gjoni i kaloi vitet e tij të fundit në Efes, ku deri ditën që vdiq, ai vazhdoi të inkurajonte dhe të ndikonte tek Kisha atje.

Çfarë do të thoshte të ishte në këtë “Rreth të Brendshëm”?

❖ **JEZUSI** investoi kohë dhe mësimdhënie të veçantë tek ata. Tani, kjo tingëllon relativisht e thjeshtë, por e vërteta është se nuk është edhe aq e thjeshtë. Në fund të fundit, ka me dhjetëra gra në bashkësinë tuaj të cilat kanë dëshirë dhe nevojë për vëmendjen, dashurinë dhe kujdesin tuaj. Por Perëndia mund t’ju flasë në zemrën tuaj për disa prej këtyre grave që Ai i zgjedh për t’i përdorur në mënyra më specifike. Duhet të jeni gjithmonë të ndjeshme ndaj Frymës së Shenjtë, sepse Ai mund të zgjedhë dikë që mund të mos jetë zgjedhja juaj personale.

❖ **JEZUSI** ndau vizionin e Tij me ta. Të ishte pjesë e Rrethit të Brendshëm nuk do të thoshte thjesht një miqësi apo një marrëdhënie “mes shokësh të ngushtë”. Sigurisht që në Trupin e Krishtit nuk duhet të ketë kurrë grupime apo ndarje nëpër klane të cilat i përjashtojnë të tjerët. Por do të thotë një kohë për të ndarë vizionin që Perëndia ju ka dhënë për të përparuar mbretërinë e Tij. Do të thotë të shpalosni zemrën tuaj për të humburit dhe të luteni e të kërkonin mënyra për ta përmbushur këtë detyrë.

❖ **JEZUSI** zbuloi natyrën e Tij njerëzore / emocionet e Tij me ta. Njerëzit e dinë që ne nuk jemi të

përsosura, dhe, nga ana tjetër as ne nuk duhet të sillemi sikur jemi të tilla! Secila prej nesh ka preferenca dhe ndjenja. Ndoshta jo gjithçka na shkon siç do të donim apo sipas planit tonë. Thelbi është që të tregojmë karakterin e Krishtit përmes mënyrës se si reagojmë ndaj situatave të vështira apo të dhimbshme.

Si drejtueset e Tij të zgjedhura, si mund të investojmë tek të tjerat? Pali i tha Timoteut që t’u mësonte të tjerëve ato që kishte mësuar, dhe këta njerëz, rrjedhimisht, do të mësonin të tjerët (2 Timoteut 2). Në thelb të kësaj qëndron ndërgjegjësimi që Mbretëria e Perëndisë është më e madhe dhe më kuptimplotë se kushdo prej nesh individualisht. Vendi që ne kemi në shërbesë është i rëndësishëm, megjithatë, ne nuk jemi të vetmet që jemi përzgjedhur për të përmbushur misionin e përjetshëm. Madje edhe Jezusi e kuptoi këtë. Ai e dinte se kur të ngrihej përsëri në qiell, ishte e domosdoshme që të linte pas njerëz të cilët do të mund ta vazhdonin punën që Ai kishte filluar në këtë tokë. Është një kompliment i madh nëse Perëndia ju lëviz nga një vendndodhje në shërbesë në një tjetër dhe ju i keni trajnuar dhe pajisur të tjerat që të vazhdojnë me besnikëri punën e Zotit derisa të përzgjidhet një bareshë tjetër.

Kjo detyrë përfshin disa gjëra shumë specifike.

❖ **NJË PËRKUSHTIM KOHOR.** Edhe ndërsa po shkruaj mund ta dëgjoj atë që po thoni, (të gjitha i kam, vetëm kohën jo). Dhe, unë e mirëkuptoj këtë koment, të gjithë e kemi thënë! Po ashtu edhe Perëndia i mirëkupton ndjenjat tuaja. Mos harroni, Ai dëshiron që puna e Tij të shkojë përpara më shumë nga sa mund ta imagjinojmë ne. Ai do ta nderojë përkushtimin tuaj me sakrificë për të gjetur kohë që të dishepullizoni shërbëtore të tjera.

❖ **NJË GATISHMËRI PËR TË TRANSMETUAR NJOHURI.** Të transmetosh njohuri nuk do të thotë gjithmonë që thjesht të qëndroni në këmbë e të jepni leksion. Unë nuk po e zvogëloj rëndësinë e mësimdhënies, sepse është jashtëzakonisht e rëndësishme që të ndajmë të vërtetat e Fjalës së Perëndisë. Por, unë besoj se metoda më efikase e trajnimit dhe e dishepullizimit është ndjekja me besnikëri e Fjalës së Perëndisë në jetët tona të përditshme. Ah, sikur të ishim edhe ne si apostulli Pali kur tha: “ *jini imitues të mi, ashtu si unë jam i Krishtit*”.

❖ **PAJISNI DHE MË PAS DELEGONI PËRGJEGJËSINË.** Për disa, delegimi i përgjegjësisë, duket shumë i vështirë. Ekzistojnë arsye të ndryshme pse kjo mund të jetë e vërtetë. Dikush mund të

mendojë që askush tjetër nuk është e kualifikuar për atë detyrë. Por, merrni parasysh gëzimin kur shihni një nga gratë, tek e cila keni investuar kohën tuaj duke punuar me të dhe duke e trajnuar, teksa pranon përgjegjësinë e udhëheqjes. Imagjinoni ç'përvojë shpërblyese është kjo për ju. Mund të ngazëlلهeni që Perëndia ju ka lejuar të keni një pjesë ndërsa ndihmoni dhe pajisni "shenjtorët" për përparimin e mëtejshëm të mbretërisë së Perëndisë.

Një tjetër arsye se përse delegimi i përgjegjësiave tek të tjerët mund të duket si diçka e vështirë, është se udhëheqësja aktuale mund të mendojë që dikush tjetër mund të bëjë një punë më të mirë. Pasiguritë nuk janë përfituese për mbretërinë e Perëndisë. Xhelozia është e gabuar. Nga ana e Shkrimit, ne duhet të gëzohemi kur të tjerët ia dalin me sukses.

❖ **KËRKONI LLOGARIDHËNIE.** Është e mundur që të monitorojmë pa kontrolluar. Kontrollimi i jetës së dikujt tjetër nuk shihet kurrë me sy të mirë dhe pothuajse gjithmonë do të rezultojë në hatërmbetje.

Udhëhiqni sipas nevojës dhe jini të disponueshme për të ofruar sugjerime. Të tjerët i vlerësojnë sugjerimet, por i kanë zët kërkesat. Jini mentorja e cila ofron sugjerime dhe udhëheqje, por që po ashtu është shumë e shpejtë edhe për të komplimentuar dhe inkurajuar.

Shpesh është e dobishme të kemi një diskutim rreth mënyrave si të përmirësojmë atë që po përpiqemi të përmbushim. Mund të habitemi nga vëllimi dhe vlera e ideve dhe mendimeve të të tjerave kur opinioni i tyre mirëpritet. Duke ndihmuar me organizimin dhe zbatimin e ideve të ndryshme që paraqiten, do t'i frymëzojmë të tjerat që të jenë më të përfshira në punën e Zotit. Mbani mend, ne jemi "bashkëpunëtorë të tij!"

❖ **ZGJERONI DETYRËN (FUNKSIONIN).** Shumë gjëra të mëdha mund të arrihen ndërsa i sfidojmë të tjerat që të shkojnë përtej vendit të cilin ato e konsiderojnë si fushën e tyre të aftësisë vetjake. Perëndia mund të ketë vendosur në shtegun tuaj një grua e cila nuk është sfiduar kurrë më parë, ose që nuk e ka kuptuar kurrë atë që Perëndia mund të bëjë me një zemër të gatshme dhe të

bindur. Trajneri i basketbollit në Kolegjin Biblik Qendror (The Central Bible College) merrte një grup studentësh të vitit të parë, të cilët shpesh nuk ishin basketbollistë të paparë, dhe i zhvillonte ata duke i kthyer në një skuadër fituese. Që kjo të ndodhte, kërkohej kohë, disiplinë, durim dhe llogaridhënie. Megjithatë, kur fitoheshin ndeshjet kishte një entuziazëm të jashtëzakonshëm. Në atë çast, lojtarët ishin falënderues për të gjithë disiplinën dhe përpjekjet që ishin kërkuar prej tyre.

Patjetër, përkushtimi për të zhvilluar dhe dishepu-llizuar të tjerat nuk do të jetë një përgjegjësi e lehtë. Do t'ju duhen shumë lutje. Do t'ju duhet shumë kohë dhe energji. Do t'ju duhet disiplinë vetjake. Do t'ju duhet gjithashtu shumë urtësi. Por, Perëndia besnik është i aftë t'ju furnizojë me gjithçka që ju duhet, për çdo detyrë që Ai ju jep. Ai do t'ju pajisë për shërbesë ndërsa ju ia nënshtroini veten Atij çdo ditë. Dita e shpërblimit do të jetë shumë më e lavdishme se sa mund ta imagjinojmë ndonjëherë.

Prandaj, të dashura gra, kërkojini Perëndisë t'ju japë urtësi ndërsa zgjidhni ato me të cilat do të punoni më nga afër. Pra, "Rethin e Brendshëm", në njëfarë mënyre. Ju lutem mos më keqkuptoni. Juve jeni pastori ose gruaja e pastorit për të gjithë bashkësinë. Perëndia do t'ju ndihmojë t'i njihni gratë që Ai ka zgjedhur për të mbushur një vend strategjik në mbretërinë e Tij. Ato pak që janë veçanërisht të përkushtuara për t'i shërbyer Mjeshtrit, ndërsa ju investoni tek ato, do të përpiqen shumë për të ndihmuar me ndërtimin e Kishës së Tij në këtë brez dhe në atë të ardhshmin. Nuk duhet të ketë humbje të udhëheqësve të pjekur në Trupin e Krishtit. Këtë, Jezusi e kuptoi dhe siguroi një shembull të cilin ne do të mund ta ndiqnim.

Është gjithmonë një përvojë e kënaqshme kur flet me gra të cilat janë plotësisht të përkushtuara për të ndjekur Jezu Krishtin. Le të zotohemi që do të lutemi për njëra-tjetrën dhe për shumë gra të tjera besnike të cilat po i shërbejnë Mjeshtrit në qytete të mëdha ose në komunitete të vogla rurale. Të gjithave na duhet një masë e veçantë urtësie dhe hiri hyjnor ndërsa po i afrohemi ardhjes së Zotit.

*Me dashuri dhe në lutje,
Marcia Lednicky*



MARCIA LEDNICKY, është një folëse e shpeshtë nëpër seminare dhe konferenca për femra. Ajo ka një aftësi unike për t'i lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat e Shkrimit. Shërbesa e saj e të folurit në publik rritet me anë të talentit të saj vokal të jashtëzakonshëm përmes të cilit ajo komunikon dhe transmeton dashurinë e Krishtit.

UJË I GJALLË NGA PUSI


Nga: **PS. GËZIM SPAHIJA**



umë besimtarë mendojnë se mbjellja e kishave të reja është një përgjegjësi që i përket vetëm pastorit. Por në fakt nuk është kështu. Çdo besimtar në kishë është një potencial i mundshëm që të mund të vihet në veprim nga Zoti për të mbjellë një kishë të re.

Si mijëra familje në vitin 2001, dhe motër Dila erdhi dhe u zhvendos nga Fushë-Arrëzi në Fllakë, në rrethin e Durrësit. Fllaka është një fshat në veri të qytetit, një zonë e varfër, pa rrugë, ujë e drita, një zonë e cila për shumë kohë në komunizëm kishte shërbyer si vend internimi për shumë persona që nuk ishin dakord me sistemin. Në ato vite, ajo u bë një zonë shumë e vështirë, me shumë probleme sociale, duke përfshirë këtu alkoolizim tejet të përhapur, abuzim fizik dhe mendor, si dhe drogë. Njerëzit ishin të pashpresë dhe robër të mëkateve të tyre. Mbi të gjitha, ajo zonë nuk kishte asnjë dëshmi për Krishtin. Pavarësisht nga sfidat, motër Dila, u ndje e thirrur nga Perëndia që të çonte ungjillin e Jezusit tek ky fshat njerëzish të lënë pas dore. Folëm me Dilën për të gjitha vështirësitë, por ajo, shumë entuziaste, tha që kishte marrë konfirmim nga Zoti përmes Fjalës së Tij.

Ditët e muajt kaluan dhe filloi lodhja, sepse ndryshimi me vendin nga ku kishte ardhur, ishte i madh. Erdhi momenti që ajo kërkonte të kthehej, por më parë donte të fliste me drejtuesit për të marrë konfirmimin e tyre. Ata i sugjeruan: "Në qoftë se ti nuk ia del dot në atë vend, është ai vend që ka nevojë për ty". Pra, ajo u kthye përsëri me më shumë dëshirë për t'u vënë në dispozicion të Zotit.





Uji sigurohej nga një pus i cili ishte në të dalë të fshatit dhe aty mund të mbushje mbasi të kishe pritur për orë të tëra në një radhë të gjatë. Ishte atje, në atë radhë pusi, vendi ku, si gruaja samaritane, Dilës i lindi ideja t'iu fliste për Jezusin grave që prisnin në radhë, dhe kur vinte radha e saj, ajo kthehej 10 radhë mbrapa për të pasur më shumë mundësi për të folur. Kështu, një nga një, dita-ditës, gratë dëgjonin dhe erdhën dhe pranimet e para, kryesisht gra dhe më pas, shumë fëmijë. Ato erdhën tek pusi për ujë të zakonshëm, por gjetën ujë të gjallë!

U fillua me shërbesa, dhe Perëndia çdo ditë i bekonte, mësonte dhe shpëtonte njerëz, duke e vërtetuar vazhdimisht Fjalën e Tij me shenja dhe mrekulli. Vështirësitë vazhdonin, por tanimë duke pasur një Zot të cilit mund t'i luteshin dhe prej të cilit mund të merrnin përgjigje.

Kështu u lutën për rrugën dhe ajo tashmë është asfaltuar e gjitha. U lutën për dritat; tani kanë drita 24 orë. U lutën për ujë; uji erdhi në çdo shtëpi. Duke përjetuar një Zot të gjallë e besnik, bashkësia rritej, dhe tani, për lavdinë e Zotit, janë 23 besimtarë të pagëzuar, 15 simpatizantë dhe rreth 60 fëmijë.

Shembuj të tillë na inkurajojnë e na motivojnë për të shërbyer edhe më shumë. Le të kujtojmë pjesët e harruara të zonave tona të shërbesës, tek të cilat akoma nuk ka një dëshmi të ungjillit. Le të nxisim çdo anëtar të kishës që, me Zotin, secili është shumicë në vendin ku Perëndia e ka thirrur, dhe se Ai dëshiron që ta përdorë dhe do ta përdorë jetën e tyre për të mbjellë kisha të reja.

GËZIM SPAHIJA, pastor, Kisha Asambleja e Perëndisë Durrës



**Këshilli i Përgjithshëm i
Asambleve të Perëndisë në Shqipëri
organizon:**

KONFERENCA E TË RINJVE IV

MISION PËR BALLKANIN

**2-4 Qershor, 2017
Durrës**



**Folës Pastor Angelo Gargano
Drejtore i Misionit A.D.I.**

*"Më kërko dhe unë
do të jap kombet.."
Psalmi 2:8*

Në Eden Park...

- ✓ Adhurim
- ✓ Mësim Bible
- ✓ Larje në pishinë
- ✓ Lojëra argëtuese
- ✓ Miqësi me njëri tjetrin

Kampi i KPAPSH-së 2017

TURNI I TË RINJVE

Mosha 18 vjeç e sipër

26 - 28 QERSHOR

Kontributi nga të rinjtë:

2000 lek/person

Kontributi nga bashkëpunëtorët:

1000 lek/person

Kontaktoni:

Pastor Walter Tuokkola

Email: wtuokkola@hotmail.com

Cel: 069 707 9531

TURNI I ADOLESHENTËVE

Mosha 13 - 17 vjeç

28 QERSHOR - 2 KORRIK

Kontributi nga adoleshentët:

2600 lek/person

Kontributi nga bashkëpunëtorët:

1000 lek/person

Kontaktoni:

Pastor Emanuele Mango

Email: elihu@live.it

Cel: 069 609 5810

Le t'i inkurajojmë adoleshentët dhe të rinjtë për të marrë pjesë në këtë kamp duke qenë të sigurt që do të jetë një rast që Perëndia do të përdorë për të prodhuar rezultate të përhjetshme në jetën e tyre.



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

...sepse Perëndia i të korrave vazhdon të thërrasë punëtorë!



Pastor, a keni nevojë që të zhvilloni bashkëpunëtorë frymërorë dhe të aftësuar në kishën tuaj? Lejoni që KTU të ndihmojë! KTU ekziston që...

- të përgatisë mbjellës kishash, pastore, misionarë dhe shërbëtarë të tjerë me dijen e Fjalës së Perëndisë dhe një shërbesë të efektshme në një kontekst pentakostal
- të mësojë teologji të shëndoshë dhe të zhvillojë udhëheqës shërbëtorë
- të avancojë ungjillin dhe të themelojë kisha pentakostale dhe të tjera ungjillore midis shqiptarëve dhe më gjerë në të tërë botën

...dhe është duke e përmbushur këtë qëllim. Pas dhjetë vitesh investimi në përgatitjen e shërbyesve, jemi duke parë frute. Pesëdhjetë të diplomuar janë duke ndikuar për Krishtin në shumë vende të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe në kombe të tjera jashtë vendit.

Në KTU, studentët do të mësojnë rëndësinë e formimit transformues të karakterit, të jetës së krishterë në komunitet, doktrinës së shëndo-shë, mësimi të mirë biblik, teologjik, misiologjik, si dhe përgatitjes së balancuar dhe serioze për shërbesë. KTU nuk është një shkollë dishepullizimi për besimtarë të rinj. Kjo është një shkollë biblike e një niveli universitar për ata që janë të thirrur për shërbesë.

Dërgimi i një studenti në KTU kërkon besim, përkushtim dhe sakrificë, por ju garantojmë që ia vlen të investosh. A dëshironi që shërbesa juaj të rritet? Atëherë mbillenit farën në trainim. Një drejtues-misionar ka thënë, *"Ai që trainon më shumë, korr më shumë shpirtëra të humbur."* Bëni një hap besimi dhe do të shikoni çfarë Perëndia do të bëjë!

Për më shumë informacion, kontaktoni:

ktu@icc-al.org ♦ Cel.: 069 406 8956